

## INTERVISTË ME BEHRAM HOTIN

Prishtinë | Data: 3 dhe 5 prill, 2017

Kohëzgjatja: 148 minuta

Të pranishëm:

- Behram Hoti (I intervistuari)
- Aurela Kadriu (Intervistuesja)
- Donjetë Berisha (Kamera)

*Simbolet e komenteve në transkriptë te komunikimi jo-verbal:*

*() - komunikim emocional*

*{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste*

*Simbole të tjera në transkriptë:*

*[ ] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin*

*Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.*

## **Pjesa e Parë**

*[Intervistuesja kërkon nga folësi që ta prezantojë vetën, familjen dhe rrethin në të cilin është rritur. Pyetja është prerë nga video-intervista]*

**Behram Hoti:** Jam djali i Hasan Jasharit. Kush është Hasan Jashari? Hasan Jashari i Likovcit të Skenderajit, i lindur në vitin 1916, mbetet i vetmi djal hasreti me tri motra. Pasi që ishin kohë t'vështira në atë kohë, ishte mretnia serbo-kroate-slovene, por udhëheqte në Drenicë mretnia e Serbisë. Në moshën dy vite, gjandarmëria e Serbisë, e përkrahur dhe e ndihmuar nga koinfidentët shqip folës, e kidnapojnë të atin e tij, domethonë Jasharin dhe e furrin, e hudhin në bunarin e kumllave nja një qind metra larg dy kullave të tij. Dhe për shej që t'gjindet kufoma kush, kur e kërkon kush, se duhet kërkuar kur njeriu mungon në familje e në lagjen e tij, në rrasën e bunarin dymdhetë parsh, bunari i kumllave, se ishte kopshti me kumlla, në rrasën e bunarit ja lan kutinë e bakfonit, duhanit, edhe qelibari... që kur vjen kush me kërkë që ka ardhë me pi ujë këtu, e të tjera, të tjera, e sheh kutinë e duhanit edhe qelibarit edhe thotë këtu qenka myt, qenka vetëvra, qenka fundosë në ujë. A e vërteta osht' kidnapu, osht' lidhë edhe osht' hudhë në bunar, kur baba jem Hasan i ka pasë dy vjet jetë.

Motrat e tij përkujdesen për t'vetmin vëlla. Të dy motrat e tij, dada Zojë dhe dada Halime, domethanë hallat e mija, martohen për nipat, për nipat e Azem Galicës për Kastratët e Bakshitë, fshatin Baksh të Skenderajit, pikërisht për Avdylin edhe për Hazirin. Ata ishin katër vllazën. Ishte daja Hazir, i imi, Abdyl i dyti, Halili i treti dhe Sinani i katërti. I katërti vëlla Sinani, i pamartuar, në vitin 1945 masakrohet në masakrën e Tivarit në Mal të Zi.

Me mija, afër katër mijë deri në tetë mijë shqiptar nga t'gjitha trojet e Kosovës, që eshalonet [kolonë] e tyne i çojnë në Tivar gjoja se, që ta njekun okupatorin, fashizmin, gjermonët, e të tjera, e ta shlirojnë Dubrovnikun, e ta shlirojnë këtë Trieshtën e të tjera, të tjera, se po rrezikohet nga Italia, nga Gjermania. A qëllimi kryesor i masakrës Tivarit ishte zbrazja e Kosovës nga shqiptarët dhe si hakmarrje e Brigadës të Bokës të Kotorrit, serbo-kroatisht quhet Bokenska Brigada, e udhëhequr nën komandën e Zyfer Musiqit edhe Petar Brajeviqit, gjeneralit, kur fillon luftën kundër Shaban Polluzhës në Drenicë.

Aty dy brigada çetniko-partizane, serbo-malazeze zhduken në luftën e Drenicës në mujin janar dhe fror [shkurt] të vitit 1945. Kur kishte pushuar pushka e fundit e Luftës së Dytë Botnore nga Moska, nga Rusia e në Pariz [Paris], Drenica e dhezë luftën kundër komunizmit, luftën kombtare shiptare për t'i bashkuar të gjitha trojet natyrale të Shqipërisë të Zotit, e jo as Shqipërisë t'madhe as Shqipërisë t'vogël, se o vetëm ni Shqipri, ajo o Shqiprija natyrale që quhet Shipni, as e madhe as e vogël.

Edhe ekziston vetëm ni Drenicë, jo Drenica e Pashës, a Drenica e Kuqe, veç ni Drenicë. Këto emërtime i kanë emërtu pushtust dhe puthadorët e tyre, Drenica e Kuqe, Drenica e Pashës, Shqiprija e madhe, Shqiprija e vogël. Edhe sot e asaj dite Qeveria e Serbisë dhe miqtë e Serbisë në Ballkan i frigohen bashkimit kombtar shqiptar, se po tenton Shqiprija me bo Shqiprinë e Madhe. S'osht' ajo Shipëri e Madhe, as e Vogël po osht' ni Shqipëri, si osht' trupi juj me këto gjymtyrë që i kini dhuratë të Zotit. Dora e djathtë e Shqipërisë e veriut, verilindjes osht' Preshevë, Bujanovc, Medvegjë që kanë metë në Serbi. Dora e majtë e Shqipërisë natyrale e kputun nga ky organizëm, nga ky trup, quhet Tetovë, Dibër, Kumanovë, Gostivar, edhe Prilep e Shkup. E ni pjesë e trupit të Shqipërisë që quhet Ulqin, Krajë, Anamali, nën Malin e Zi, ajo osht' tokë e Shqipërisë natyrale. E met pra veç ni trup i sakatosur, i coptuar, i prerë nga gjymtyrtë dhe mbijetoi. Si quhet ky trup? Quhet Kosovë, quhet Kosovë.

E osht' i vetmi djal që u martu te motra, te dhondri, te motra, baba im Hasan Jashari. Kush është ky? Masi që jeni gazetare [I drejtohet intervistueses] duhet t'ju tregoj se Milaim Zeka o stërnip i tij. Kryesisht gjyshja e tij, dada Vahide e mori vllaun e vet në moshën nondë vjeçare, sepse ja mbytën, ja pren me sakica edhe nanën, ajo, edhe nanën, për m'ia trashëgu pasurinë, se kumllat e Hasan Jasharit...

**Aurela Kadriu:** Domethënë gjyshja juj?

**Behram Hoti:** {pohon} gjyshën time. Kumllat e Hasan Jasharit, aty ishin me dheta, me pesëdhjet hektarë të mixhallarve t'tij, të kusherive t'tij, që menihere mas vrasjes të Azem Galicës ata shprëngulen për Shqipri. Pikërisht babgjyshi i Lulzim Bashës osht', edhe babgjyshi im, babat vllazën. Pra Lulzim Basha e ka prejardhjen nga tamli, nga nana, nana e tij dhe unë jemi kusheri të dytë me gjak, e ka prejardhjen prej Drenice, pikërisht prej Likovci, jo as pej Peje, as pej Mitrovice po pej Drenice prej Likovci.

E kush e njef Lulzim Bashën mirë në Shqipri, e njef Flamur Gashi i cili ishte ni djal i përkushtum, i viteve '90-ta për pajtimin e gjaqeve dhe për bashkimin kombtar në Kosovë. Pikërisht Flamur Gashi, ni kontribus i jashtëzakonshëm në pajtimet e gjaqeve, kalon në Shqipri, atje shkollohet studimet e larta dhe mrrin mu ba kryeshef, shef i kabinetit të Lulzim Bashës, sa ai ishte Ministër i Punëve të Jashtme. Tash osht' drejtor, kshilltar kryesor politik i Kryetarit të Shqipërisë aktuale, të Bujar Nishanit. Prandaj une...

**Aurela Kadriu:** Zotëri Behram, a kthehemi vetëm pak te familja juj? Masi që gjyshi, babgjyshi juj

domethanë...

**Behram Hoti:** Për herë t'parë para televizionit i flas këto fjalë për familjen time. Në moshën, në vitin... kthehet baba në Likovc, martohet...

**Aurela Kadriu:** Qysh ka qenë jeta e babës t'juj meqenëse babën ja kanë vra forcat serbe?

**Behram Hoti:** Motrat e tij e kanë rritë.

**Aurela Kadriu:** Po. Mandej kur është ...

**Behram Hoti:** Dhondri i tij, pikërisht dhondri i tij Hoxhë Abria, Arif Zeka, babgjyshi i Milaim Zekës, e ka përkrahë, e ka martu në familjen e vet dhe pas martesës me ndryshim e, me ardhjen e Qeverisë të 1939 kur vjen edhe në pjesë të Shqiprisë, po në Kosovë, Gjermonia edhe Italia ju munsohet... shpesh here babën kur e kom pyet sa vjet i ki bre babë, ka thonë, "Dy vjet..." "Kur?" "Sa ka qenë këtu Gjermonia edhe Italia atëherë kemi qenë t'libër". Kthehet në vendlindjen e vet, në tokën e vet, në djepin e vet, martohet.

Pikërisht martohet me mesën e Azem Galicës, domethanë me motrën e dhanurve t'vet nga Baksi, me nanën time Zelijen. Nana ime Zeliye kur i ka pasë dymdhjetë vjeç ka qenë në kerr, [në] ven mashkulli të martesës të Azem Galicës për herë t'dytë, kur Azemi, kur Shota e Azemit e marton burrin e vet për shkak që t'ketë trashigimtar Azem Galica, nana ime ka qenë në kerr. Prandaj unë jom edhe stërnip i Galicës po edhe stërnip i Shaban Polluzhës, sepse dajtë e mi që i kom nga Baksi, Kastrat, dhe familja e Shaban Polluzhës, Kastrat jonë, t'ni barku, ni familje.

Në vitin 1947 formohet organizata, mas luftime, për bashkimin e Kosovës me Shqipri. Në krye të asaj organizate ishte Skender Kosova, ish-komandanti gjandarmërisë i shërbimeve sekrete të Tiranës, 1947, dhe e kishte prejardhjen dikun nga Llapi. Dalin veprimtarët nga Shqipria në Kosovë, vijnë te familjet ma të, ma të besume, formojnë qelulat e tyne për bashkimin e Kosovës me Shqipri, bashkimin e Kosovës me Shqipri.

Baba im është jataku i tyre. Vritet Skender Kosova. Gjandarmëria dhe shërbimet sekrete të Serbisë, të Jugosllavisë në atë kohë, zbulojnë ata që i kanë, janë burgos përpara edhe thojnë në fshatin Likovc edhe dymdhjetë fshatrave tjerë, besnikun ma t'madh e kemi pasë Hasan Jasharin, prandaj baba im quhet edhe Hasan Besa. Hasan Likovci, Hasan Jashari, Hasan Besa. Kur burgoset baba asni bashkë-veprimtar të tyre t'organizatës për bashkimin kombtar nuk e deklaroi në gjykatë të Prishtinës qitu...

**Aurela Kadriu:** Domethonë edhe baba juj ka qenë i persekutum?

**Behram Hoti:** I persekutum dhe i dënum, dhe nëpër burgje të, maspari në Skenderaj, në Mitrovicë, në

Prishtinë, në Nish, në Sremska Mitrovicë e deri në Goli Otok.

**Aurela Kadriu:** Edhe në Goli Otok!

**Behram Hoti:** I burgosur në Nish...

**Aurela Kadriu:** A ju ka tregu baba diçka për këto kujtime t’ij nëpër burgje, a dini diçka?

**Behram Hoti:** Qysh jo, qysh jo...

**Aurela Kadriu:** A ju bin në mend?

**Behram Hoti:** Une jom fmiu ma, i pari i shkollun edhe jom profesori i parë i Likovcit dhe jom poeti i parë i Drenicës dhe shkrimtari, e të tjera, të tjera. Para meje osht’ Nebil Duraku në Drenicë si shkrimtar. Unë e kom botu veprën e parë letrare në Drenicë, prej që i thuhet Drenicë, emni shyp [shqip] Drenicë, veprën e parë letrare, autori i asaj vepre jom unë. Prandaj e kom fitu, meritu emrin poeti dhe shkrimtari i Drenicës.

**Aurela Kadriu:** N’cilin vit e keni botu?

**Behram Hoti:** 1965, kur i kom pas 19 vjet, vitin e dytë, vitin e parë të shkollës si normalist, 1965. Esad Mekuli e ka botu veprën dhetë vjet para meje, 1955. Autor osht’ Behram Hoti i kësaj vepre “Ligjerimet e mia”, kurse redaktor osht’ Esad Mekuli dhe Hasan Mekuli. Kush osht’ Esad Mekuli dhe Hasan Mekuli? Dy shqiptarë intelektual t’devotshëm, që krejt poetët, poetët ma t’devotshëm të Kosovës, kanë përkrahjen nga Esad Mekuli sepse ishte kryeredaktor i revistës “Jeta e Re”. Dhe aty tuboheshin gjithë shkrimtarët, poetët e talentum që shpërndaheshin nëpër krejt Kosovën. Në mesin e tyre, për shembull Din Mehmeti, Ali Podrimja, Mehmet Kajtazi i Drenicës, Nebil Duraku i Drenicës, e të tjerë, e të tjerë.

**Aurela Kadriu:** Zotëri Hoti a mundeni me na i tregu kujtimet e babës nëpër burgje qysh... ?

**Behram Hoti:** Kujtimet e babës, e kom ni...

**Aurela Kadriu:** Sidomos në Goli Otok...

**Behram Hoti:** Po, e kom ni kujtim shumë t’freskët e t’paharrushëm kur mrrin, dënohet në Prishtinë, në gjygin e qarkut. Atë kohë, atë kohë, prokuror ushtarak ishte Ali Shukriu, kurse zavenës i tij, prokuror zavendës i tij ishte Selim Obranqa. Populli i Llapit e ka qujt Selim Zeshku se ka qenë pak, ftyrën e tij, tenin e ftyrës e ka pasë zeshkan. Kush osht’ Selim Obranqa? Ni ndër partizanët ma t’devotshëm të territorit të Llapit, në luftën 1944, ‘45, dej t’fundin ‘45. Cila ishte ajo luftë? Nacional Çlirimtare.

Ai kishe hy si partizan në luftën Nacional Çlirimtare që t’shlirohet populli shqiptar nga zgjedhja

serbo-sllave e madhe dhe të fiton lirinë dhe kado që flitet gjuha shqipe t'jetë Shipni, kado që t'ka shiptar t'bahet Republika Kombtare Shiptare e Shipnisë.

Por në vitin 1945, '45, kah shkurti, frori, shkurt, kur u nisën brigadat edhe shqiptare, brigada e shtatë shiptare për Beqej, për Kikindë, për Srem, me një gjermanin nga Ballkani, atëherë Partia Komuniste e Jugosllavisë në krye me Josip Broz Titon, me këtë, krimineli ma i, ma i rrezikshëm i popullit shiptar Rankoviqin, Aleksander Rankoviqin, e të tjerë, e të tjerë... urdhun që mos... dej në Srem ka qenë komanda në shqip, komanda e shtatë, e brigadës shtatë kosovare, ka qenë komisar i asaj brigade Qamil Brovina nga Gjakova, kurse Shaban Haxhija ka qenë komandant nga Tropoja e Shqiprisë.

Atëherë, atëherë, ndërrohet komanda, deri at ditë ka qenë tungjatjeta, gaditu, përpara, djathtas ktheu, majtas ktheu, e të tjera, aty thotë, thonë, meniherë u ndrru komanda... thonë, "*Ode zima dodje leto, nema vise tungatjeta*", shkoj dimri, erdh pranvera, nuk ka ma tungatjeta, veç shkinisht, veç serbisht. U bo tradhëtia ma e madhe në Ballkan kundër shqiptarve. Atëherë i erdhën depesht [telegram], emra e mbiemra, Selim Obranqës që t'i gjykojë në gjyjin e qarkut, jo larg këtu qitu te plepat që thonë.

Vjen lista që t'dënohen e t'burgosën, ishin burgos veç, m'u dënu me pushkatim luftarët e brigadës Drenicës në krye me komandant Shaban Polluzhën, sepse komandanti Shaban Polluzha ishte vra bashkë me Mehmet Galicën [Gradica]. Edhe baba im me shoktë e tij, me besniktë e tij dhe me shoktë dhe besniktë nga Shqiprija që i kishte mixhallart atje në Shqipri, e kusherijtë e parë, formojnë organizatën për bashkimin e Kosovës.

Ajo organizatë zbulohet dhe baba bjen në burg. Dënohet në gjyjin ushtarak të Prishtinës, gjykatën e gjyjit t'qarkut dhe transportohet në burgun e Nishit. Nuk vanon shumë, Selim Obranqa refuzon gjykimin edhe nënshkrimet e vendimeve që t'burgosen shiptart, e t'pushkatohen. Në Strelë, osht' veni në Prishtinë quhet Sterlishtë, aty jonë pushkatu Gjon Serreqi, Shaban Bajku të fshatit Muqivërc, të Kamenicës. Aty jonë pushkatu shumë, shumë shiptar aty po t'i përmena kta dy, e ka edhe të tjerë.

Dhe vjen, dezerton Selim Obranqa, i thotë lamtumirë postit, kolltukut t'partizanve, e heton se osht' tradhtu nga partizanët edhe arrestohet, arratiset, jo arrestohet arratiset në mal. Fillimisht strehohet te ni hallë e vet në fshatin këtu te Dragushë e Purgovcit dhe aty kontakton me shehun e Llapit që kishte autoritet në qarqet e komunizmit në atë kohë për, për Kosovë këtu, në Prishtinë edhe në Llap. Edhe shehu i thotë, "Bir në dorë," këto jonë fjalë të Selim Obranqës, se unë e kom ditarin e Selim Obranqës, veç unë e kom ditarin edhe kërkush, edhe fotografitë e tij nga lufta... thotë, "do t'dënohesh, noshta ni vjet, noshta dy vjet, jeta t'garantohet, bir në dorë". Bjen në dorë, dënohet, vjen në burgun e Nishit edhe takohet me babën tim, me Hasan Jasharin në burg.

Aty fillun m'u bo vllazni t'u i tregu njoni tjetrit... sepse Selimi i thotë, "O Hasan Jashari kur ka ardhë brigada e Drenicës me Shaban Polluzhën e Mehmet Galicën në Podjevë me i çu për Srem e Kikindë, e në Beqej me luftu kundër gjermanve, ka qenë e caktume mi likfidu dikun kah Prepellaci, në tren si

t'hyprin edhe me thonë boni në deshje treni në kthesë u përmys, e mu shkatërru krejt. Unë kom qenë” thotë, “nën kulmin e komandës” tash në Podjevë ku o. “E kom pasë t'kurdisun sharcin”, mitrolozin, sharc t'gjermanit, “që kur t'vjen komanda pej Prishtinë me ju korr me të tjerët krejt”. Thotë “Por, nuk ke kysmet, tash erdha në burg u takova me ty” edhe bohen si vllazën. “Sa djem i ke?” Thotë “I kom shtatë...”

**Aurela Kadriu:** E pyt baba juj Selimin?

**Behram Hoti:** Po, po. “Shtatë, t'ri krejt”. “Njo me ma falë mu”. “Po,” thotë, “vlla Selim po ta fali, po për çfarë arsye, qysh?” “M'u bo dhondër i Llapit”. Pasi që intimisht po flas për herë t'parë, dhe unë, baba m'fal mu për Selim Obranqën edhe bohna dhondërr i Llapit, edhe unë jom dhondërr i Llapit dhe dhondërr i parë i Llapit. Por, osht' kryetari aktual i Podjevës që quhet Agim mbiemnin Veliu, baba i tij, baba i tij, ka qenë korier i brigadës Shaban Polluzhës në luftën e Drenicës. Prandej, na Drenica me Llap ka pasë, nuk, nuk po i, po i ndaj territoret, po kemi pasë t'shkume t'ardhun vazhdimisht. Edhe pikërisht emnin e, i korierit të Shaban, t'shtabit të Shaban Polluzhës, osht' Nuhi Bradashi i kanë thonë, Nuhi Gashi, Nuhi Bradashi.

Unë në vitin... baba nëpër burgje. Vijn represionet, bastisjet e shtëpisë tonë, na mesim si zojt e qurës veç me nanën. Po dajtë e mi të Baksit na kanë rritë, jonë kujdes për neve, na kanë sjellë mish, na kanë sjellë bukë, na kanë sjellë lakna turshi, na kanë sjellë gjitha t'mirat, dru... edhe unë në vitin 1959, në fund të '59, domethonë në shtator, e kryj shkollën fillore në Likovc dhe jam nxansi ma i devotshëm në atë, jo veç në Likovc po në krejt komunën e Skenderajit, nxansi ma i mire. Me sjellje, me nota. Ka pasë edhe të tjerë mas meje, po pas meje vjen si nxans i jashtëzakonshëm, doktor Sadik Zeka, doktori parë i Abrisë, a unë bohna normalist në Prishtinë. Dha provimin pranus. Me mu ishin edhe disa të tjerë nga Abria, e të tjerë, e të tjerë, që sot flasin nëpër televizione nuk i përmenin kolegët e tyre. Ata s'mujtën me dhonë provimin në Shkollë Normale, unë e dhashë provimin se isha krejt i shkëlqyshëm, e dhashë provimin edhe bohna normalist dhe...

Profesort e mi të Shkollës Normale, pjesa dërmuse ishin, kishin krye shkollën e mesme normale në Elbasan. Ishin aq t'devotshëm. N'mesin e tyre Beqir Kastrati, ni profesor, ni shqiptar, ni atdhetar, ni vizionar, ni poliglot, dinte shume gjuhë, e të tjera, ka qenë kujdestari im. Por, prapë djemtë e Llapit që kisha ni klasë, ma msunë pak a shumë gjuhën serbo-kroate. Sepse gruja e Gjon Shirokës e qujtun profesoresh e, ja kom ditë edhe emnin qitash m'kujtohet, thojke, “*Ako ne znaš ti si iz Drenice, ako ne znaš srpski jezik kao Ali Šukrija nećes nikad prolaziti, dobiti prolaznu cenu*”. Nëse nuk e njef gjuhën serbo-kroate si Ali Shukriu ti notë pozitive nuk ke. Por, djemtë e Podjevës kishin, i kishin kojshi familjet serbe e malazeze e njifshin gjuhën. Më merrshin natën tinëzisht, ilegalisht në banesat e tyre e ma msojshin gjuhën serbo-kroatisht, m'çojshin edhe në Kino Rininë ktu... të gjithë ata m'kanë përkrahë, m'kanë...

**Aurela Kadriu:** Ku banojshit ju gjatë kësaj kohe?

**Behram Hoti:** Unë, unë banojsha në banesë private që ma gjeti Fazli Grajçevci, se Fazlia m'ka regjistru në Shkollë Normale, Fazli Grajçevci patrioti dhe simboli i flamurit kombtar. Dhe ai kur u burgos nuk e deklaroi asni bashkëpunëtor t'tij, për atë arsye pjesa dërrmuse që kemi bashkëpunu me te edhe si djem t'ri jemi gjallë, nuk e tregoi në gjyq kush. Une banojsha në, këtu në rrugën Vllaznim Bashkim te pazari në ni banesë në dhe, në përdhese. M'i bleu Fazlia qeben, jarganin... çdo t'dille vinte, se punonte në Dobërshevc si msus. Aty banojsha une, se jo në konvikt, se une nuk kisha të drejtë pasi e kisha babën e burgosun politik kundër qeverisë, kundër Partisë Komuniste...

**Aurela Kadriu:** Baba vazhdonte me qenë në burg në kohën që ishit në Normale?

**Behram Hoti:** Në burg, në burg në burg...

**Aurela Kadriu:** Sa vite i ka bo burg baba?

**Behram Hoti:** Tetë vjet. E këtë, as në internat me qenë, se une e kisha patkonin e djalit të ballistit, djalit nacionalistit që ja ka kthy pushkën partizanve, se në brigadën e Shaban Polluzhës baba e udhëheqte ni kompani, ishte luftëtar i Bajraktarit të Hotit, Rrustem Bajraktarit të Plluzhinës edhe i Shaban Plluzhës. E tash une s'kisha të drejtë në pension, ksi, në burs, kurrfarë kredie, as nuk kisha të drejtë m'u pranue në konvikt. Nuk i kishim na disa djem që ke, që ka, sepse familja jonë, familja jonë ishte e leqitun prej Partisë Komuniste, prej Lidhjes Socialiste.

Nuk guxonte kush me ardh me prashit në arat tona, me korrë, as me kositë, as në darsmën e vllaut kur e kena martu vllaun, bacen Selmon. Ka ardh vetëm ni njeri i Likovcit me kerr e kuaj edhe me grun e tij, në darsëm, se asni njeri nuk ka pasë të drejtë me guxu prej Partisë Komuniste me ardh në familjen tonë, kem qenë t'leqitun... edhe, edhe pesë, gjashtë vjet masi që ka ardhë baba pej... dej me përfundimin, me rrximin e Aleksandër Rankoviqit.

Pastaj jonë torturat gjatë aksionit t'armëve si në Podjevë, ashtu edhe në Drenicë, e në Dukagjin e në krejt Kosovën, ushtrohet akc... torturat e krejt... unë e kryj Normalen, e kryj fakultetin e gjuhës dhe letërsisë kombtare në Prishtinë. Isha në ni... fillova studimet post-diplomike bashkë me Jusuf Buxhovin e të tjerë, bashkë me... dhe u njoftova me djem të Rugovës, maspari me Zymer Nezirin, me Isa Demajn e të tjerë.

**Aurela Kadriu:** A keni qenë i angazhum politikisht gjatë kohës Normales edhe fakultetit?

**Behram Hoti:** Po, patjetër.

**Aurela Kadriu:** A na tregoni pak për qat' periudhë qysh ka qenë?

**Behram Hoti:** Patjetër. Une jom noshta ndër t'vetmit intelektual i burgosun i asaj kohe në Armatën e



Jugosllavisë.

**Aurela Kadriu:** Gjatë cilës kohë?

**Behram Hoti:** Jo, jo, jo burg, me pasë ni gazetë anti Serbisë ose të Shqipërisë në xhep, ose ni libër të Enver Hoxhës, po veprim aktiv.

**Aurela Kadriu:** A po na shpjegoni qito edhe a kanë ndodhë gjatë studimeve a po?

**Behram Hoti:** Këto, menihere, ishte viti 1980, 1968. Për me kthy t'mirën e vendlindjes time kthehna profesor i gjuhës shqipe në Likovc. Po qëllimi i...

**Aurela Kadriu:** Mbas Normales apo mbas studimeve?

**Behram Hoti:** Mbas studimeve. Qëllimi ishte, se ishte Lëvizja Kombtare atëhere...

**Aurela Kadriu:** N'cilin vit po flasim?

**Behram Hoti:** 1968. Ishte Lëvizja Kombtare dhe përgatditshëm me ngrit flamurin për ditën me 28 [nëntor]. Dhe pikërisht këto durtë e nxansit e tij të cilët sot janë profesor, e mjek, e doktor shkencash, po janë luftëtar të ushtrisë, të UÇK-së në Drenicë, por jo vetëm në Drenicë, edhe në tri luftat, edhe une jom pjesëtar dhe veteran i tri luftave... Ishin nxansit e mij ata me profesorin e tyne dhe me Vesel Zekën, bashkëpunëtorin tim në Likovc, arsimtar, që e ngrita, e ngritëm flamurin mi kulmin e shkollës të Likovcit, e jo nëpër therra, nëpër bandera, nëpër... mi kulmin në institucion. Erdhën policia, manifestim... e vunë letrën aty që, "Ndërpritet manifestimi!" Se na e kishim për 28 nëntor, e jo me 29. 29 ish dita e Republikës të Jugosllavisë, a 28 ishte dita e Republikës Shqiptare.

E qitën në derë t'shollës. Na në aborr valle, kangë e recitime. I vetmi unë isha në veshë kombtare. Ata bashkëpunëtorët e mi, msusit e arsimtarët ishin pjesa dërrmose anëtarë të Lidhjes komuniste, ju thashë, "Ju jeni të lirë. Mos merrni pjesë se ju largojnë prej Lidhjes Komuniste, ju largojnë prej pune, unë e kom marrë përsipër këtë punë". I vetmi njeri me nxansit e tij, disa edhe ju kanë vra në këtë luftë, e të tjerë, veshë kombtare, që do t'jau sjelli atë fotografi, atë, atë pjesë t'librit, atë fotografi, e ngritëm flamurin. E qitën në derë m'u shpërnda, urdhresën.

Atëherë i thashë Shefkije Zymberit pej Likovci dhe Hamide, Hamide prej kat... lagjës të Cmokajve të Abrisë, Hamides, nxanses t'klasës tetë, "Shkyne se une ju mbroj juve". Natyrisht që kisha me çka m'i mbrojt sa isha gjallë [i ri], kisha me çka m'i mbrojtë... po as nuk m'u afrunë mu, as nuk i trazunë... dy kampanjona me polic. Kishte edhe shqiptarë në atë kohë policë, por pak, ma tepër shkyje. Edhe nuk e arrestun, nuk m'arrestun atë ditë, po masanej pasun arrestimet.

Dhe pikërisht në '90, në fund të '90 e... 1969 unë burgosem si ushtarak, fillimisht në Postojnë të

Sllovenisë. Mandej burgjet i maj në Postojnë, në kazermat Titova Kazerma e Titos, Titova Kazerma në Lublanë. Prej Lublanit në burgun ushtarak të oficerëve në Zagreb, ku aty denohna në gjykatën supreme të Armatës të Jugosllavisë me burg, edhe burgun, një pjesë t'madhe t'burgut e kryj në Kopër të Sllovenisë edhe në Shibenik e në disa vene tjera. Në gjykimin tim i lejohet vetëm babës me marrë pjesë edhe ni kusherinit tonë që quhet djali i Xhemajl Bajraktarit, Rrustem e ka emnin, Rrustem Bajraktari, i cili punonte aso kohe në Zagreb edhe kishte ardhë baba m'u strehu te ai e t'nesrit me dalë në gjykatën supreme. Dënohem për grabitjen, thyrjen e magazinave t'ushtrisë, grabitjen e armëve t'ushtrisë edhe sjelljen e tyne në Likovc të Drenicës. Kullat e mija, kullat e babës. Me shumë ditë i organizum, por asni njeri nuk ka pësue vetëm unë dhe vllau im Jashari...

**Aurela Kadriu:** A ka qenë e vërtetë kjo?

**Behram Hoti:** E vërtetë. Vllau im civil dënohet me dy vjet e gjysë, unë dënohna tetë vjet. Vllau im, Jashar Jashari, burgoset me mu bashkë edhe e vuejm dënimin. Une ushtarak, ai civil. Në Mitrovicë, e të tjera. Kush është Jashari? Është baba i dëshmorit që ka ra ditën me, me komandantin, komandantin e Brigadës "Adem Jashari" në Vërbovc të Drenicës, Ilaz Kodra. Pra është baba i dëshmorit Lutfi Jashari.

**Aurela Kadriu:** A mundeni me na tregu...

**Behram Hoti:** Jo, Lutfi, por Fazli Jashari. E mandej e kryj burgun, nuk m'lejojnë me punu kërkun...

**Aurela Kadriu:** A mundeni me na tregu pak përvojat në burg? Torturat, vitet në burg, gjatë burgjeve, qato përvoja pak nëse mundeni me na tregu.

**Behram Hoti:** Po...

**Aurela Kadriu:** Po besoj ju kujtohen.

**Behram Hoti:** Sot... si me ju tregu kur ju jeni t'reja, ju do...

**Aurela Kadriu:** Po për njerzt që e shohin...

**Behram Hoti:** Ju do t'bohni nana t'reja. Sa jeni kështu vajza jeni t'dobishme e t'madhërishme, e shumë... po nuk jeni t'shejta. Kur ju përkundni djepa baheni nana t'shejta. E unë nuk kom qef me trazu shpirtin e ju sepse boll na trazoj lufta me Serbinë. Po, po ju thom kte se burgjet e Serbisë, civile, diku jonë të trajtum nëpër burgje, nëpër biseda informative, mi gjysë milioni shiptar, nëpër burgje të studentve t'vitet, demonstratat e studentve '81 e të tjera edhe para tyre, edhe para tyre... burgjet ma t'egra.

Na s'i kemi përjetu burgjet në Shqipri, e të tjera, në Amerikë, e anej knej, mirëpo burgjet ma të, ma

t'ashpra, ma anti-njerëzore kanë qenë burgjet e destinime për shqiptar të Kosovës, burgjet civile. E mos t'flasim për burgjet ushtarake. Une edhe pasi që e kom kry ushtrinë kom qenë i përcjellun në shërbime, prej shërbimeve sekrete, zbulim ku...

**Aurela Kadriu:** N'cilin vit e keni kry ushtrinë?

**Behram Hoti:** Ushtrinë e kom kry në vitin 1900... tri herë u dashtë me shku ushtar une se ma kanë ndërpre, m'kanë burgos, a je tu m'kuptu? Po pjesa që m'ka metë u dashtë me shku me kry. Eh, burgjet ushtarake kanë dallu prej burgjeve civile sepse burgju im osht', nuk osht' i zakonshëm, osht' i veçantë dhe osht' i pari profesor i gjuhës shqiptare që burgoset në atë mnyrë, grabit armët, në burg aktiv, që ato armë i duheshin Kosovës për me fillu luftën e duhur.

**Aurela Kadriu:** A mundeni me na tregu qat' aksionin e grabitjes t'armëve qysh e keni organizu, kush ka qenë me juve? Disa, diçka rreth qasaj...

**Behram Hoti:** Kam pasë ushtarë nga...

**Aurela Kadriu:** N'cilin vit ka ndodhë?

**Behram Hoti:** Vitin '70. Kam pasë ushtarë nga Ulqini...

**Aurela Kadriu:** Si t'erdh ideja për atë aksion?

**Behram Hoti:** ...nga Maqedonia. Ideja ime ka qenë gjithmonë me furnizu shpinë time, pragun e shpisë me armë. Edhe para se me shku ushtar unë e kom furnizu familjen time, e nipat e mi, e të tjerë, e të tjerë, me armë. Kom qenë i pregaditun gjithmonë. E kom ditë se duhet t'vjen ni ditë që të rrokim armët. Dhe pikërisht në Likovc, veni i shtabit të UÇK-së, kur kem fillue ushtrimet e para, pikërisht baba im e dorëzon pushken e tij manzere, t're, ja dorëzon ushtrisë tonë. "Qe," thotë, "me kte muni ju m'i, m'i gju helikoptertë e Serbisë". Se në fillim dikush e merrte ni pushkë gjuetie edhe une po i bashkohem UÇK-së, dikush s'kishte armë fare.

E u duhke me shku në Shqipri me marrë armë e mi pru 80 e sa kilometra, me ka 50 kilogramë në shpinë, e të tjera, m'i pru në Likovc, e pej Likovci m'i shpërnda në tana antë. Po plaku im tha, "Bir..." edhe nxansve t'mi kur i çilshum istikamet në mes Likovci edhe Makërmali, jonë zabelet e Makërmalit aty istikamet, për me bo zonën e lirisë t'luftës aty në Drenicë. Tha, "Ja këta," p'i ju thotë nxansve t'mi aty që ishin ardhë tash, ishin bo, ishin rritë, ishin ardhë me fillu luftën në Drenicë, "ja plaku tjetër s'ka këtë armë me pasë". "Ku e ki?" Tha, "I kom une tjetër kun armët".

Dhe Hasan Jashari me 17 shtator, 16, 17, pas ni beteje t'ashpër, osht' i vetmi njeri që nuk e ka lshu kurrë pragun e shpisë në Likovc. Shaban Jashari, Ademi e Hamza në Prekaz, e ka ndodhë edhe dika tjetër kah, ku me ditë, po në Likovc osht' i vetmi njeri që u dashtë na m'i lshu, krejt ushtria, shtabi, se

kanë msy me dy qind tenka e sa që mos t'damtohet ushtria, që mos t'damtohet popullata, se Likovci ishte bo oazë, zonë e lirë. Mbi afër 50 mijë refugjatë nga gjitha katunet tjera të Drenicës, jo veç të Drenicës po edhe të Llapit, kishin ardh në zonën e, aty në Likovc. U duft, duhej m'i largue popullatën në vene tjera që kur t'hyn ushtria e Serbisë në Likovc mos ta, mos t'vret e mos t'ketë me vra njerz e...

**Aurela Kadriu:** Zoti Behrami a mundeni veç me na tregu ma shumë për detaje rreth këtij aksioni për grabitjen e armëve? N'cilin vit ka ndodhë, qysh është organizu?

**Behram Hoti:** Unë në vitin '69 isha ndër ushtarët, edhe ata që mbajsha ligjëratë ushtarëve, isha i nominur me ardhë si nën-toger kur ta kryj ushtrinë, ni vjeçare. Por, oficerit e mi, për fat t'mirë, ishin pjesa dërrmuse kroat, Tomisllav Badovinac, kroat, komandant i bataljonit, e të tjerë. Ju spjegova se qëllimi im osh' me kry ushtrinë e m'u kthy në vendlindje me kontribu atje si profesor, sepse ka nevojë Kosova për profesorë e për msusa. Ata kishin dëshirë unë m'u ba oficer aktiv sepse ish, sipas tyne edhe ish e vërteta, isha i shkathtë une, shumë i shkathtë, shumë i pregaditun në përdorimin e armëve t'gjitha llojeve, sepse kisha, qysh me kohë, na e këm traditë familjare atë punë e kemi pasë. Qëllimi im, intimisht, i unit tim, ish me sjellë armë në Likovc. Në vendlindjen time. Në kullat e mija.

**Aurela Kadriu:** Domethonë ju pranut pozitën si nën-togerit?

**Behram Hoti:** Tre muj ditë para se me kry ushtrinë une i solla armët në Likovc, sepse si, si ushtar i, i aftë, me edukatë ushtarake t'largtë, i fitojshe 15 ditë pushim familjar, me shku në familje, si dhuratë. E une gjatë, gjatë asaj kohe i organizova djemtë edhe disa mashkuj tjerë, t'fshatrave tjera të Drenicës, po sidomos të Likovcit, që ishin me punë në Celje të Sllovenisë, në Postojnë edhe në, ni qytet tjetër, Maribor. Nuk ju kisha tregue çka ka në ata... n'atë kohë ka pasë dyshek, dyshek t'fjetjes për dy vet, e për ni njeri... Prindtë e juj ose babgjisht e juj mujn mi majt në men, kanë qenë shumë t'fortë, t'kepun mirë e t'trashë. Atëherë vllau im Jashari edhe disa djem tjerë që punojshin me te në Celje, e shkepën dhe futën arme, se arma shprëndahet, pjesë-pjesë nxjerrët edhe i futën në dyshek disa armë aty. Për shembull, në mesin e tyre edhe automat t'parë, që s'kishte pa kërkush në Drenicë në atë kohë automat.

**Aurela Kadriu:** Qysh i nxerrët ju këto armë?

**Behram Hoti:** Une i nxorra.

**Aurela Kadriu:** A na tregon qysh?

**Behram Hoti:** Sepse unë kisha ni autoritet të jashtëzakonshëm aty. Po, i sigurova çelësat e magazinës, kur isha në ushtrime të ndryshme, niherë njo niherë njo dhe i kalojsa jashta oborrit, jashta kazermave në mal edhe i pshtillsha në najllon atje, i lasha. Aty i merrte, i merrshin njerzt e mi, i futshin nëpër, blejshin qata dyshek, i futshin në dysheka, edhe ata dysheka dhe dyer në Lublanë ose në Celje... si tash në Prishtinë që bo, shtëpijat e vjetra i prishin për me maru rrokaqiej, pallate të mëdha.

Dyert atje kanë qenë me sanaka të, dyer e dritare t'gjana edhe Sllovenia osht' e njohur me pishë, e me dyer, me dritare, me.... Për shembull, "Lesna" në Kosovë, firma e dyer e dritare, "Lesna" e ka prejardhjen nga Sllovenia, e njohun...

Tha, i thashë vllaut, "Kqyr ku ka aso dyer që shesin, që i kanë lanë me u shit, që i kanë prish shtëpijat e vjetra, qysh në kohën e Austro-Hungarisë që i kanë bo ata pallate, me ndërto, me bo, me bo, modernizimin e shtetit, infrastrukturën e qytetit... edhe mushe". Atëherë i thojshin lesh dreqi asi si pamuk e si, "Mbushe edhe lshoj pjesët e armëve në kapak të derës. A p'e sheh edhe dera e ka kapakun e vet {tregon me dorë kah dera}, po kjo e ngushtë osht' si kapaku... ngjite drrasën në kit' anë knej edhe qite në tren në Lublanë, adresa Gllogo, Gllogovc, Drenas tash në Gllogovc në Drenicë," edhe i kisha t'organizum njerzit nga Likovci me shku me i marrë me kerr me kuaj.

**Aurela Kadriu:** Qysh komunikojshit ju prej brenda me njerzt jashtë? Prej ushtrisë...

**Behram Hoti:** ...ku, kha? Une vet kom marrë tri here, pushime kom marrë...

**Aurela Kadriu:** Domethonë, qashtu u organizojshit?

**Behram Hoti:** ... kur e kom pa marrë, dhonë une këtë komandën, gjeneral Jorzhe Zhbatit të zonës nondë ushtarake të Jugosllavisë, si e kom ndërpre tha, "15 ditë i ki dhuratë me shku me vizitu familjen", a je tu marrë... kom qenë i djathtë për ato punë...

**Aurela Kadriu:** E gjatë qësjaj periudhe 15 dite e keni organizu aksionin a?

**Behram Hoti:** 15 ditë, tri herë ka 15 ditë. E atëhere i kom thonë babës, "Fillo me marue kullën e re, shpijat e reja... kur t'vinë dritaret edhe dyrtë, le t... populli, le t'merr vesh kjo Likovci që po maron shpija edhe këto dyerë e dritare, p'i çonë djali që osht' në Slloveni". A je tu m'kuptu? Edhe si tash që blen maqina t'lamjes e këso p'i Gjermonie, e ata dyerë e dritare ata shiteshin, si në Prishtinë me shitë dyerë e dritare dikush e p'i... edhe në tren, vishin vetun, në tren.

Dilte baba, vllaznit tjerë, kusherit, e me kuaj, kerr me kuaj i marrshin dyr e dritare i çojshin në Likovc. Ata pjesa dërmuse nuk e kanë dit çka ka aty. Shumë konspirativ, po disa e kanë ditë. I kanë hjek pej dyshekve edhe pej dyerë e dritareve, i kanë pregadit dyrë e dritare për kullat e reja, se na deri në këtë luftën e funit tri kulla, tri shpija t'mdhaja i kemi pasë ka 25-26 metra t'gjatë, t'gjata, edhe janë mshef.

Kur u arrestova unë, se fillunë regjistrimi edhe fillunë me, fillunë me i maltretu ata magazinert e, "Ku jonë metë armët?" E anej knej... dhe e hetova une mejherë që ka depërtue ni, ni dyshim. Atëherë, e, e thirra vllaun thashë, "Qysh osht' puna?" Tha, "Po flitet se e kanë arrestu babën", babën jo, po "nanën edhe vllaun tjetër". A je t'u m'kuptu? N'bisedë informative kështu i kanë, "Po flitet se je i dyshuar ti". Atëherë unë vullnetarisht u dorëzova, se kisha nërmen nashta edhe atje me nis luftë, ni luftë t'vogël, u

dorëzova kur niva që nanën e kom në burg. A nuk kishte, nuk kishte qenë e vërtetë. E shkrova letrën.

Erdh ni, ni ndër gjeneralët me dyqind e sa ushtarë, erdhën prej Sllovenie në fshatin Likovc, erdhën e rrethekun fshatin. Shkun në familje dhe i thanë babës, “Ja letrën e djalit ton. Ne na duhen veç armët që i ka pru ai këtu, ai o shnosh e mirë”. Unë isha në burg. “Shnosh e mirë osht’, na duhen veç armët e ushtrisë, armët tua që i ka t’familjes jo veç t’ushtrisë”, edhe thotë, “që i ka pru djali këtu. Djali osht’ mirë, shnosh e mirë osht’. Ka qenë ushtari ma i famshëm, numër ni ka qenë në krejt batalionin e Lublanit, të Postojnës, po ka ndodhë kjo se djali ka, kishte pa një anërr...”

Se une në gjykim thashë, “E kom pa ni anërr që kanë hi çetniktë në Drenicë edhe po vinë me ma masakru familjen, si përpara qysh ma kanë masakruë”. A je tu m’kuptu? Edhe ashtu e kisha pa une atë anërr. Edhe ajo anërr edhe deklaratë në gjyq m’ndihmoj mu shumë. Psiqikisht ka pa anërr edhe për këtë arsye e ka armatos shpinë e vet, pa, pa ju tregu kërkuj që për çfarë arsye unë i kom pru armët atje. Kështu osht’ rrugëtimi i armëve t’ardhun prej Sllovenie për herë t’parë, dhe kurrë mo kërkush s’ka mujt me bon ni punë t’tillë, ni vepër t’tillë. Po i kom pasë shoktë e fortë. M’kanë pyt a vetun a me, fikall vetun. Po kush i çoj atje, vllau. Se unë e disha që vllau nuk tregon kërkuj, qysh jom une, vllau. Po m’përputhi vllau me punë në Celje, në Slloveni.... Edhe, kështu ka qenë rrugëtimi i armëve.

*[Kjo pjesë e intervistës është realizuar më 5 prill, 2017]*

## Pjesa e Dytë

**Aurela Kadriu:** Zotni Behram, a mundeni me na fol pak për periudhën e viteve të ‘70?

**Behram Hoti:** Po, po ja fillojmë. Vitet ‘70, pikërisht 1970, unë isha i burgosur në burgun ushtarak të oficerëve në Zagreb. Filloi ni lulëzim Kosova e kishte ato vite ‘70 deri në vitet 1978, ‘79, aty pari. Pasi që Kosova fitoi, me ndihmën e Zotit edhe me përkushtimin e popullit e të kombit, Univerzitetin e Kosovës, çdo vit Kosova nxjerrte gjenerata t’jashtëzakonshme studentore, t’shkollave t’mesme. Atëherë, Univerziteti i Kosovës numronte 35 mijë deri në 50 mijë studentë.

Vitet ‘70-ta janë ndër vitet ma t’suksesshme që ndonihërë ka përjetu Kosova, historia e Kosovës, historia e popullit të Kosovës, historia e shiptarve të Kosovës. Pas Universitetit të Prishtinës në vitin ‘74 erdhi kushtetuta e Krahinës Socialiste Autonome e Kosovës në nivel të Federatës së Jugosllavisë që gati ishte republikë Kosova, po vetëm nuk e kishte akademinë ushtarake. I mungonte akademia ushtarake sepse gjitha institucionet tjera Kosova i dispononte me akademinë policore, akademinë e shkencave e të arteve, Univerzitetin, të gjitha. Por, për këtë arsye pasunë kërkesat që Kosova të shpallet Republikë, por ishte e pa... e pamunshme sepse nuk lejonte kurrsesi Republika e Serbisë e cila dëshironte vazhdimisht me majt nën sqtull, nën thundër Kosovën, po nuk ia arriti.

Deri në vitet '74, '75, '76, Kosova jo vetëm që lulëzoi intelektualisht, në shkencë, në kulturë e në arsim, po përjetoi edhe lulzim ekonomik. Trepça ishte garancë e krejt Jugosllavisë, Jugosllavisë federative për tenderët që i thonë sot. Garanca për në tanë Evropën për ndërtim rindërtim, Trepça punonte Serbia e Jugosllavia fitonte. Populli ishte në gjendje t'katandisur të, të t'varfnisë.

Deri në vitin 1974 kur arriti kushtetuta, institucionet e Kosovës, organizatat punuse, punësimi i shqiptarve në Kosovë në proporcion me minoritetin, që ishte në Kosovë minoritet atëhere po e sundonte Kosovën, minoritetin sllav, serbo-sllav, dikun në çdo organizatë ishin t'punsum tetë, shtatë, ose ni ose dy shqiptar. Me arritjen, me fitim e kushtetutës të '74-tës atëhere filloi përtrirja, ringjallja, punësimi proporcionalisht edhe përdorimi i gjuhëve, i gjuhës shqipe. N'gjitha institucionet fillun me u përkthyer aktet normative nëpër çdo organizatë punuse, se deri atëhere statutet e ndryshme, aktet normative, rregulloret e punës ishin vetëm në gjuhën shqipe, në gjuhën serbo-kroate, nuk kishte në gjuhë shqipe. Shumë t'burgosur që u kthyen prej burgjeve të ndryshme, profesorë, student, u emnun nëpër organizata punuese si administratorë edhe përkthys e referenta të dy-gjuhësisë.

**Aurela Kadriu:** Zotëri Behram...

**Behram Hoti:** Une deri në '74 isha në burgje të Serbisë, por "Rilindja" vinte edhe në burgjet tona, e vetmja gazetë e Kosovës në at kohë. Ka çka t'flitet për këto vite mjaft.

**Aurela Kadriu:** A mundeni me na tregu qeto vitet në burg, kujtimet e qatyne viteve në burg edhe çka keni bo manej mas burgut?

**Behram Hoti:** Kujtimet, nuk isha i vetmi shqiptar une nëpër burgje. Burgjet ishin mbush edhe në atë kohë me shqiptar ma herët që vuenin dënimin. Ni kujtim t'pa harruer e kom kur na kalonin prej qelive të burgjeve në oborin ku ishte shëtitorja. Muret ishin t'larta pesë-gjashtë metra t'rrethekume me gjemba e krejt, në katër muret e oborreve, ato t'begene si kala... duhej me i majt duert ose përpara kështu {tregon me duar} ose mas shpine edhe mos me shikue as majtas as djathtas. Po une e vidhsha shikimin në katër qoshet e mureve të oborrit, mure t'nalta. Ishin në gjendje gadishmërie ka dy-tre ushtar edhe pushko-mitrolezi i gatshëm. Për ne ishte e pamundun me ik e me u largu pej burgu, po ja këtë, këtë, sidomos ndoshta vetëm për shiptar ishin ato roje të jashtëzakonshme që, që t'krijohet një panik në shpirt edhe në zemrën tonë, e në dinjitetin tonë, e në moralin tonë. Përkundrazi morali ynë forcohej edhe ma tutje.

Të burgosurit shkojshin kështu në rreth {tregon me dorë në shenjë rrethi}, një ka një, njoni pas tjetrit. Atje kah shtatë-tetë metra, dhetë metra, e pash një djalosh i cili me moshë ishte ma i ri se unë sigurisht... dhe i kishim na uniformën e ushtrisë po nuk kishim shenja t'ushtrisë, për shembull yllin e komunizmit, po kapelen e ushtrisë, në kohën e dimnit kur ish dimër e kishim obërllukun e ushtrisë veshun, uniformën e ushtrisë... ai ma lujti dorën e m'përshtëndeti. Sigurisht kishte hetu se ka ardhë këtu në këtë burg ni intelektual nga Kosova. Kurrë nuk muj me ditë kush ka qenë ai djal, djal i gjatë, ushtar, i ri. Edhe sot e atë ditë e kom pikë në zemër me mujt me identifiku atë djalosh kush ke, kah ke,

e kështu. Ai për mu ka qenë... edhe meniher oficeretë, roja e oficerve, ushtarakët, policia ushtarake e Jugosllavisë e kidnapoi në oborr edhe e çunë atje në qeli apo ku me ditë ka e çunë. Unë ma nuk e pash.

**Aurela Kadriu:** Çka ka qenë angazhimi i juj mandej mbasi që keni dal prej burgut?

**Behram Hoti:** Kur shkrujsha ndoni letër nga burgu e kisha ni besnik ni postier Feriz Nurajn i Plluzhinës që shkojshin letrat e mija te nana, te baba e te vllaznit. Ai i merrte në postë ato letra edhe i runte. Natën shkonte nën hije t'mollës ose t'dardhës ose mas hijeve t'kashtës, e ja lexonte nanës, babës se i kisha analfabet. Njeri shumë i devotshëm. Pas, pasi që erdh kushtetuta fillunë, fitum amnestisë, une u amnistova, dola prej burgu dhe erdha në Prishtinë. Si njeri, profesor i diplomur ishte e pamundun me hy në punë kun, me rrok ditarin, me hy në punë, kudo që shkojsha, edhe nëpër fshatra. Për shembull, kom shku në fshatin Ujëmire atje, të Klinës, të Pejës, ku, ku kufizohet Drenica, ishte një drejtor që e njëfsha përpara, drejtor i shkollës, më tha, "Behram," më tha, "e kemi listën për shumë njerz, ti je në listë, nuk mun ta merrsh ditarin, m'vjen keq". Aty e ktej të gjitha nuk mujsha, nuk mujshem me hy nëpër punë.

Ndodhi kjo e mirë e njerëzimit. Sherif Ahmeti, e kom fotografinë e tij, këtu e kom, Mulla Sherif Ahmeti ishte drejtor i Medrezës... Medreza ishte sikur e ndame prej shkollave t'shtetit. Ishte drejtor i Medrezës në Prishtinë këtu... dhe Muhamet Pirraku, profesor Muhamet Pirraku e informon thotë, "Osht' ni djalosh nga Drenica, osht' profesor osht' i papunë, a ka mumsi me ardhë e me dhanë gjuhën shqipe?" "Po," thotë, "ka mumsi". Edhe më pranoj Mulla Sherif Ahmeti ilegalisht te medresantët. Kështu që, shumë hoxhallarë e islamologë që i shihni ditën e Bajramit kur falet Bajrami për shembull, ky Bajgora, Sadri Bajgora, Sadri apo... ai osht' nxansi im në Medreze edhe shumë të tjerë, Mulla Xhevat Kryeziu, Mulla Fetah Bekolli, Mulla Ali Vërmica, Mulla... të gjithë ata hoxhallarë që kanë marrë pjesë në pajtimin e gjaqeve që ma vonë mund të m'kujtohen emnat e tyne, t'gjithë kanë qenë nxansit e mi në Medreze.

**Aurela Kadriu:** Deri në cilin vit?

**Behram Hoti:** Aty e regjistrova për herë t'parë edhe ni djalosh, kusheri, djali i babës kusheri. Baba i tij kusheri i babës tim, sepse në familjen time në kohën e aksionit t'pushkve, në kohën e Rankoviqit, nuk mundte me ardhë kërkush me korrë nëpër ara, me prashit, me kosit. N'darsma ishte e ndalume me ardhë njerëzit dasmor në familje tonë se ishte familje e leqitur, e largume nga Lidhja Socialiste. E Selmon Murati i Likovcit, ai e përkrahte familjen tonë. Masi që fillova une punën në Medreze erdh ni natë t'vonshme në shpinë tonë, në kullën tonë edhe i tha babës, tha, "Unë këtë djali, i kom" tha, "gjashtë djem, këtë djali ja kom falë" tha, "profesorit" tha, "Behram Hotit ja kom falë". Se une isha i njohur jo si Jashari në atë kohë, se une jam Behram, me mbiemën familjar Jashari, e tha, "Ja fala Behram Hotit këtë djali". "Po, po, ky i ri, ky djali," tha, "por, e kryen sivjet" tha, "shkollën tetë-vjeçare, klasën e tetë". Edhe baba kishte dëshirë me e çu për msus ose inzhinjer, ose doktorr, ose në atë kohë m'u shkollu.



Sepse ishte i burgosur politik baba im, kishte nejt me njerz t’devotshëm, kombtar t’devotshëm nëpër burgje. Tha, “Jo,” tha, “une po ja fali” tha, “me ba hoxhë, me ma regjistru në Medreze”. Edhe ai osht’ Mulla Osmon Muslija, që del nëpër debate të ndryshme kundër terrorizmit, e kundër vehabizmit, e të tjera. Mulla Osmon Musliu, i cili e pat’ fatin edhe gadishmërinë, edhe guximin, mori pjesë në varrimin e Jasharve në Prekaz. Ai hoxha osht’ me uniformë. Aty ka pasë edhe hoxhallarë të tjerë po kanë qenë civil. Ky i vetmi ka qenë me uniform dhe e pikasin televizionet botërore CNN-i e BBC-ja, ka i shkojnë lotët ka i shikon kufomat e Jasharve edhe në varrimin e Jasharve. Kështu që, ai është një hoxhë i devotshëm.

**Aurela Kadriu:** Deri në cilin vit keni punu në Medrezë?

**Behram Hoti:** Në Medreze kom punu në ‘74-tën.

**Aurela Kadriu:** Vetëm në ‘74-tën?

**Behram Hoti:** Vetëm në ‘74-tën, shtatë-tetë muj.

**Aurela Kadriu:** Mandej pas Medrezës?

**Behram Hoti:** Pas Medreze kam punu në shkollën “Branislav Nushiq” ni kohë, po ku m’bishin në gjurma drejtori thoshte, “Nuk kom, nuk guxojna me t’majt”. Kom punu, prej aty, kom punu në Milloshevë, me gjetë njerz t’devotshëm, njerz t’guximshëm, ku ishte drejtori. Në ni mënyrë ilegale gati m’pranonte disa muj, shtatë muj, pesë muj... kom punu në Besi, periferi të Prishtinës, kom punue në, si profesor gjuhe në Lluzhan. Kështu që, aty kom qenë i njohur me familjet, për shembull me Gërvalltë, me Zeqir Gërvallën e Ahmet Gërvallën, e djalin e vllaut tij, me familjen Zhitia... kom punue në katunin Shipol të Mitrovicës, atje në shkollë fillore kom dhonë gjuhën shqipe... kështu me rradhë disa vende, deri...

Harrova me ju thanë se para se me shku, para se me shku ushtar edhe para se me u burgos, une nja katër muj, pesë muj kom qenë edhe gazetar i “Rilindjes”. Por pasi që “Rilindja” ishte nën mbikqyrjen, nën hetimet, atëhere i thojshim UDB, shërbimet sekrete ushtarake shtetrorë të Serbisë, të Jugosllavisë, po kryesisht të Serbisë, posa i identifikojshin se jonë fmi, jonë punsu në “Rilindje” fmitë e familjeve balliste, nacionaliste, fmitë e prindve të burgosun, i largonin prej pune meniherë. Kur kom punu une në “Rilindje” pesë muj, shtatë muj, ka qenë drejtor Mehmet Shoshi.

Edhe më tha, “Profesor, je i hetum, e kanë vërtetu t’kaluarën tane, t’familjes tane”. Tha, “Ma mirë me, me u tërhjek prej ‘Rilindje’ me vetdëshirë me marrveshje, se s’po mundem me t’thonë që t’kemi me t’largo, t’kemi përjashtu, sepse osht’, ja unë me u largu si drejtor i ‘Rilindjes’, ja ju”. Thashë, “Jo, jo, ju lutem ju veç punoni”, edhe une me marrveshje, e nënshkrava marrveshjen. Sot e kom vendimin. Po shumë vendime, shumë shkrime, shumë, gjithë, shumë dëshmi arkivore jonë djegë sepse katunet

tona, kullat tona jonë djeg jonë bo rrafsh me tokë. Aty m'u ka djeg edhe baba, në ato kulla, e të tjera.

Prej vitit 1912 kur shkel koma e ushta... e ushtarve çetnikë të Serbisë në Kosovë, në Llap, e në Drenicë, e në Dukagjin e në tona antë dhe ecin në 1913, e kalojnë Zhurin, hyn në Kuks në Lum, e synojnë me dal në Durrës me pushtu edhe Shqiprinë krejt, për çdo ditë mbi 400 shiptarë në ditje jonë pushkatu. Prej vitit 1912 a '13, familja e ime i ka, në vitin 1912 i dalin me manzere t'mretit ushtrisë të Serbisë përpara. Ai osht' Osmon Isuf Isufi, baba i babgjyshit të Lulzim Bashës, i cili e trashëgon emrin e tij. Tjetri osht' Hysen Bajrami i fshatit, edhe Rexh, Rexh i mahallës tjetër... tre dëshmorë. Në Drenicë jonë dëshmortë e parë, i pushkatojnë, i nxojnë t'gjallë, i vrasin dhe varret e tyre janë në oborrin e xhamisë të Plluzhinës. Aty kemi edhe Bajraktarin e Hotit, Rrustem Bajraktarin, tash e trashëgon Bajraktarin tonë Hasan Tahir Bajraktari.

**Aurela Kadriu:** Zoti Behram, cili ka qenë angazhimi juj në demonstratat e vitit 1981?

**Behram Hoti:** '81?

**Aurela Kadriu:** Po.

**Behram Hoti:** Demonstratat e vitit 1981. Unë kom qenë i punsumë në '74, '81 në Shtëpinë e Shëndetin në Prishtinë. Në '81, si referent për dy-gjuhësi, për akte normative kur jonë pranë nondë punëtor shqiptar e ni puntor serb. Struktura e punësimit nacionale kur ka ecë përpara, unë kom qenë në Shtëpinë e Shëndetit. Demonstratat, në demonstratat e vitit 1981, unë kom shkru shumë për ato demonstrata, kom përjetu... harrova me ju thanë se edhe kom punu në shkollën "Emin Duraku" në Prishtinë, atëhere edhe në "Branisllav Nushiq", po në shkollën "Emin Duraku" ni vjet. Aty e kom pasë nxañsë Fahri Makollin, Makollt e Lluzhanit. Fahria në demonstratat e '81-shës plagoset para parlamenti, aty tash ku o parlamenti, aty plagoset. Une punojsha në... isha, e njëfsha mirë si nxañs, e çumë me veturë në spital atje... edhe Boro Moraqiqi, një kirurg i përbetum anti-shiptar, sidomos kundër rinisë, kundër studentve, në ven që me ja rujtë dorën, llërën e dorës, shuplakën e dorës, gishtat, ja preu, se ishte, ishin lëndu prej gazit lotsjells, ja preu katër gishtat, e i met vetëm ni gisht. Sot nxañs im Fahri Mekolli e ka vetëm ni gisht.

Unë pasi që isha i shpurdhitë [gjindshëm] dhe në atë kohë i kom... shpesh here e kom vozitë ndihmën e shpejtë në demonstrata. I kom bajtë t'plagosurit, ishte edhe shoferi aty, po shpesh unë, se kom qenë edhe vozitës i jashëzakonshëm. E kom vozitë ndihmën e shpejtë e i kom çu t'plagosurit në QKUS që o spitali, në atë kohë. Demonstratat e '81-shës ishin, ishte ni rilindje e kombit e popullit shiptar në Kosovë. Ato nuk ishin demonstrata, ajo ishte luftë, ishte kryengritje, kryengritje ishte, luftë ishte.

**Aurela Kadriu:** A keni pasë...

**Behram Hoti:** Populli, po flas këtu, unë e kom taku bashkëshorten time pa ditë une, me shoqet e saj kojshije, që kishte shoqe, bashkëpunëtores nëpër punë, t'u pregadit petlla, bukë, ujë, kepë e t'gjitha...

a shihni këtë anë, atëhere quhej Dragodan, kjo kodra ku osht' Arbria tash, ajo ishte Dragodan, asni shtëpi nuk ka qenë në atë anë, ka qenë krejt ara, dhé i shkapërderdhun. Në vitet e '70-ta kanë qenë lojnat e shoqatës t'motorrve të Ballkanit, të Jugosllavisë, ushtronin me olimpiadën e Ballkanit në motorra kush po e ze venin e parë. E na duke, t'u ik prej policie, prej ushtrie edhe në atë pjesë anej t'u strehu deri te vorret atje, deri atje kemi shku kamë, e jemi kthy prapë. Osht' rruga e Bihaqit, quhet rruga e Bihaqit te pazari, te tregu i Prishtinës, tregu i gjelbërt i Prishtinës, rruga e Bihaqit që del atje te xhamija, te mullini Bankoviçe quhet te xhamija e Llapit në atë anë anej...

Aty unë kom qenë prezent kur Ismet Krasniqi osht' vra. Unë kom qenë aty prezent kur osht' vra demonstranti, ni nga demonstrantët e parë nga Sveqlla, djali i Llapit, isha prezent aty gjithë, sepse t'thashë që e kom vozitë ndihmën e shpejtë. Noshta prej qasaj ndihmës shpejtë kur erdh njësia speciale e Jugosllavisë, e ushtrisë dhe e policisë, osht'... ku o ky Nevborni [Newborn] aty që o qendra rekreative e rinisë, atëherë quhej "Boro dhe Ramizi"...

Aty në ata tre rrokaqiejt aty, ballë për ballë ku oshtë guvernatori, banka e pagesave, ata rreziteshin në ata tre rrokaqiej dilshin, dilshin veç në breg policët, ushtarët nëpër ballkona e na provo...na provokonin. Noshta prej ndihme... pas ni javë dite gazetat e Serbisë shkrun me t'mëdha *iz kola hitne pomoci kazali su specijalnu jedinicu JNA*, Armatës Jugosllave, nga kerri i ndihmës shpejtë me automatik dikush i ka gjujtë policinë edhe ushtrinë nëpër ballkona. Deri vonë kanë qenë shejat prej kerri t'ndihmës shpejtë, noshta ato durë jonë gjallë, që e kanë, e kanë shkrep atë. Për herë t'parë po flas. Po osht' gjallë shoferi që ka qenë me mu.

Për këtë arsye demonstratat e '81-shin, ato quheshin demonstrata por ato, ajo ishte ni luftë, ajo ishte ni kryengritje edhe ma... as Jugosllavia, as dashamirtë e Jugosllavisë e të Serbisë nuk mujshin me manipuliu mo me, me shkrime, me t'pa vërteta, me t'pa vërteta gjoja se shiptartë po e... janë t'përkdhelun pej federate, gjoja se po i shkollojmë, gjoja se po i punësojmë, e të tjera, të tjera...

## Pjesa e Tretë

**Behram Hoti:** Jonë pararendës i Pajtimeve të Gjaqeve vitit '90.

**Aurela Kadriu:** Qysh jeni përfshi ju në Pajtimin e Gjaqeve?

**Behram Hoti:** Unë, pasi që kom fol ma herët, pasi që gjyshen time dhe babgjyshin tim, njerzit mendjelehtë, të prirur nga lakmia për pasuri, m'i zhduk njerzit të tjerë mi ua trashëgu pasurinë... pasi që babgjyshin tim e gjetën të mytun, e t'lidhun, e t'furrun në bunar, pasi që gjyshen time e grinë me sopata t'u i mjelë delet në ahër të shtëpijave të t'afërmive t'babës tim, që kishin, pas vrasjes së Azem Galicës, kishin migru në Shqipri, krejt ato, ajo pasuri i kishte metë babës tim. Baba im i kishte vetëm tri motra edhe asni vëlla. Tash fillon, që t'likfidohet edhe baba, se motrat ishin martu. Motra ma e re, e mori babën edhe e martoj në familjen e vet. Tri vjet ka jetu baba te motra e vet, i martun, i martun, tri

vjet.

Erdhën kohra të reja. U kërkun, u kërkun vrasësit e babgjyshit, u kërkun vrasësit e gjyshes, u kërkun vrasësit e Rushit Osmanit. Kush osht' Rushit Osmani? Osht' i vllai babgjyshit të Lulzim Bashës, bacit Isuf në Tiranë. Dhe filloi në bazë të Kanunit... atëherë, ishte kryetar i pajtimeve t'gjaqeve Shaban Polluzha, e Bajraktari i Llaushës, e të tjerë, a kryetar i *islihatit* në Kosovë jonë këto vite, jonë këto vite '26, '27 deri '30, '39. Pasi që fillunë m'u pajtu, se në vitin ka, '40, fillonte Lufta e Dytë Botërore edhe kishte fillu propaganda e partisë komuniste, e komunizmit në atë kohë me i mashtru shqiptartë hyni në luftë, se pas lufte ka flitet gjuha shqipe, ka flitet gjuha shqipe do t'bohët Shqipni, do t'bohët Shqipni. Do t'shlirohen niherë e përgjithmonë shiptartë pi çetnikve, e pej okupatorve.

Fillunë, filloi m'i gjetë m'u identifiku kush ishin ata vrasës. Vrasësi me gjithë vlla t'vet u burgos... këto janë t'dhimshme këto... shkoi në Nish. Njoni, njoni vrasës vdiq në Nish, njeni, njenin e lirunë. Baba me dashamirtë e tij filloi m'u hakmarrë, kur na s'ishim t'lemë e t'lindur asnjë, dhe e nxorr gjakun e nanës. Prej atij momenti në shpirtin tim ka hy se gjakderdhja, vlla-vrasja... Shikoni, ata që e sulmun familjen tonë, e likfidun familjen tonë, ja lamë historisë. Ata ishin shumë t'domshëm për shiptar. Por, flitet se pushkë hakmarrëse për nanën e vet, e për babën e vet kush nuk ka qit' si plaku im, pushkë pozitive. Po, pastaj fillunë, unë, lindi në shpirtin tim edhe isha student i profesor Anton Çettës dhe shumë të tjerë, e njëfsha jashtëzakonisht mirë, se kur erdh baba prej burgu profesori e vizitoi babën në Drenicë...Mori tregime, anekdota të ndryshme historike, politike, gjithë atë urtinë e tuboi, vazhdimisht vinte në Drenicë. Kur fillunë, u vranë 30 e sa djem t'ri nëpër Armatën Jugosllave. Të burgosurit politik që ishin në atë kohë, që dulën prej burgjeve, prej burgu, para vitit '90, për shembull Myrvete Dreshaj profesoreshë, për shembull, ky Adem Grabovci, Dreshaj ni, gjithashtu, Lulzim Dreshaj, Hava Shala.

U organizun nëpër burgje që me i mjellë ka ni fidane, ka ni lule për gjithë ata dëshmor që, edhe me fillu mi bo pajtimet e gjaqeve. Paraprakisht, para, para vitit '90, '89 kur minatorët e Trepçës u mbyllën në zgafellë, 900 metra fell, në horizontin e nondë, u hetu aty se dikush nja dy, tre, katër minatorë mes veti jonë në gjak familjet e tyne. U organizun dhe i falen gjaqet, i falen gjaqet. Prandaj, gjaqet e para janë falë pikrisht në Trepçe. Myrvete Dreshaj, Hava Shala, e të tjerë, Adem Grabovci, e të tjerë, Et'hem Çeku, e të tjerë, erdhën në Institutin Albanologjik në Prishtinë. Pikërisht, fillimisht ishte ky viti, fillimi i vitit shkurt 1990. U takunë me profesorin e nderuar Zekrija Canën, sepse ai ishte kryetar për të drejtat e njeriut, se Serbia vriste djem t'ri, në ushtri, i binte në kufoma, vriste nëpër demonstrata, burgoste.

Profesor Zekrija Cana ishte në krye të detyrës nacionale, kombtare, kryetar i Këshillit për Drejta të Njeriut edhe profesori i tha, "Une po, do t'ju bashkangjitem, por e kem na profesorin e nderuar i cili e njef urtinë popullore, vujtjet e popullit, ka studiu, i ka shkru blenet tregimet për Drenicë", e të tjera, të tjera... Edhe profesor Anton Çetta në gjendje fillon, në gjendje gadishmërie pranon me u bo, me ju bashkangjit studentëve me formu Lëvizjen. Dhe dy javë besë, në Lumbardh, kur dalin, kur dalin rinia me i falë do gjaqe, me kërkun faljen e gjaqeve, pajtimin e familjeve, në ditën e parë me 2 shkurt 1990, në Lumbardh të Dukagjinit marrin veç 15 ditë besë. Por, mandej Lëvizja masivizohet. Kështu që për ni

ditë Drenica fali mbi 120 gjaqe.

**Aurela Kadriu:** E ju keni qenë prej ditës t'parë?

**Behram Hoti:** Prej ditës t'parë me profesorin, si ni ndër kordinatorët të anës Drenicës, po edhe... Kordinator tjetër, pajtimtar i devotshëm Avdi Kelmendi, organizator i Lipjanit, Muhamet Pirraku, Mujë Rugova. Mujë Rugova e ka shkatërru ni kerr t'ri gjatë pajtimeve, mos t'flasëm për benzini që ka shpenzu, po kerrin t'u, ka katër – pesë profesor në kerrin e tij edhe u shkatërru. Hoxhë Idriz Kosova, Idriz Kokrruki, gjithashtu, kurse profesor Muhamet Pirraku e shet ni lopë bashkë me viq për derivate, për benzini t'veturave. U masovizu, dolën autobusa, mini autobusa, traktora, në katër antë e Kosovës u shëndrru ajo Lëvizje, u shëndrru në, në ofanzivë për t'mirën e njerëzimit sepse motoja jonë, fjala jonë kryesore nëpër tubime t'mëdha ishte duhet me pajtu gjaqet se me hasmëri nuk hyhet në luftë për njeri. Konkretisht, me qenë profesori, ky që po flet, prite za me qenë jo, në hasmëri me pasë t'kufizime lirinë e lëvizjes nuk ishëm na sot qëtu, t'u bisedu e t'u bo intervistë. Kështu.

**Aurela Kadriu:** Qysh i keni organizu ju në Drenicë, qysh osht' organizu Pajtimi në Drenicë?

**Behram Hoti:** Rinia e shkollave t'mesme dhe studentët, merita ma, ma piedestale osht', Lëvizja e Pajtimeve të Gjaqeve i referohet rinisë, jo profesorëve. Rinia nëpër fshatra me traktora, natën, ditën, t'u le qentë, t'u kcy gardhiqe, t'u pasë vazhdimisht t'u qenë t'frigum, e me panikë që po i gjurmon policija, po i burgos, po i rrah, po i sakaton, sidomos natën shkojshin nëpër familje. Fillunë Këshillat e Pajtimeve nëpër çdo fshat, profesortë, nxansit e profesortë, msustë e shkollave fillore, t'mesme... Edhe shkojshin prej ni familje në ni familje [tjetër], e pregaditshin tubimin, faljen e gjakut, e caktonin, e caktojshëm ditën kur m'u majtë tubimi në Qirez, kur m'u majtë tubimi në Palluzhë, kur m'u majtë tubimi në Likovc, kur m'u majtë tubimi në Llaushë, kur, kur m'u majtë tubimi në Prekaz, edhe kështu.

**Aurela Kadriu:** A na tregoni për këto tubime pak, qysh kanë qenë, për shembull të Lumbardhi, Verrat e Llukës edhe këto që i përmendët?

**Behram Hoti:** Kjo osht' ni ndihëm e Zotit, si kjo pranverë që jemi tash, që s'ka forcë e fuqi me e shkatërru këtë gjelbrim. Populli u vetëdijsu, populli ishte i gatshëm me i falë ka tri gjaqe. Për shembull, doktor, profesor, aktualisht rektor, Marjan Demaj i falë tri gjaqe të tre vllazërve. Unë i kom aty fotografitë.

**Aurela Kadriu:** A keni qenë ju në atë pajtim?

**Behram Hoti:** Po, qysh jo në atë pajtim. Edhe e shprehu dëshirën me ardhë me neve vazhdimisht prej atij momenti, se ai që e falte gjakun, ni gjak e dy, ai bohet, bohej automatikisht pajtimtari ma i famshëm, se i thojshim atij zotnisë, prindit, nanës, motrës, po ja ku e kemi profesorin i ka falë tre gjaqe. Ja ku e kemi Nezir Vajvodën e Llaushës e ka falë gjakun e djalit. Kush ishte Nezir Vajvoda? Baba i Selmon Vajvodës, e që sot quhet në Mitrovicë ura e gjakut që e vajtën në demonstratat e Mitrovicës

djalin e tij. Për këtë arsye lloj-lloj forme pregaditshëm vetëm që t'falin, t'bohët falja, t'mirren në gryk. Zgjatja e dorës t'pajtimimit, bisedat tona që ishin nihere nëpër familje, nëpër lagje, ku tuboheshim natën, bisedat tona ishin se me ja zgjat dorën osht' madhështore, po me marr në gryk dorasin, anëtarin e familjes t'dorasit, vrasës, vrasësin, me marrë në gryk me këtë që p'i ia zgjat dorën, që p'i ia fal gjakun...

Ne shpesh herë jemi frigu. Për shembull, në Karaqevë në tubimin e Karaqevës, për shembull në tubimin e te bunari Hajratit, në livadhet e Prishtinës këtu te Medreza e re tash që osht'... na frigoeshim kur dilte e ja zgjate dorën frigoeshim që po i thotë ky, "Ti e ke bo kte kte kte..." t'akuzon para populli edhe, "ty duhet me ta pre kryet", për shembull anej knej, kurrë s'ka ndodhë ajo. Po, ka ndodhë kjo, "Gjakun ia fali rinisë të Kosovës, gjakun ia fali Kosovës, gjakun ja fali atdheut, gjakun ia fali Univerzitetit të Kosovës". E nuk i thoshte për shembull, nuk ka ndodhë me thonë që, "Ty s'ta fali gjakun kurrë!"

Ka pasë pajtime që i kemi bo në vitin 1990, kanë qenë edhe ma t'vjetra se 1945, se para Luftës Dytë Botnore, edhe ma t'vjetra kanë qenë. Kryesisht, kryesisht dorasit, jo familja, dorasit kanë qenë mendje shkurtë, kanë qenë të prirur nga lakmija e paarsyetushme e pasurisë tjetërkuj. Për shembull, ka pasë momente kur ka qenë edhe familja e varfër dhe ka kcy gardhin dhe ka marrë do kallamoq në koshin e kallamoqit t'misrit t'kojshisë aty, t'mahallës.

Aty osht' ndëgju ajo, s'po muj me thanë ajo vjedhje, për me majt familjen, varfria e madhe tepër që kishte ushtru Qeveria e Serbisë kundër familjeve, ishte katandis, diku nondhet, tedhet përqind familjet shqiptare ishin në gjendje t'mjerushme. Detyrohej kryefamiljari me shku me marrë ni lis në zabel tjetërkuj e për m'i nxe fmitë e vet, atëhere takohej me të zotin e zabelit aty, fjalë pas fjale i metë në dorë, domethonë njoni tjetrin e mytshin, fillonte hasmëria. N'anën tjetër, këto ishin shumë t'rana, po ato ma t'rana ishin kur okupatori Serbia, UDB-a, shërbimet sekrete të Millosheviqit, jo, po të Rankoviqit në atë kohë, se Millosheviqi osht trashëgimtar i Rankoviqit po osht ma i ri ai...

N'kohën e Rankoviqit, për shembull, ata, Serbia e dinte mirë, shpirtnisht kishte hy në familje, me shkatërru familjen, e dinte se shiptartë janë t'prirun me pasë armë e duhen me pasë armë e.... Ja jepte ni pushkë e bonte për veti, dhe ai me atë pushkë e vriste, e bonte شمار, pylltar të malit, e vriste ni njeri për dy-tri fjalë, nuk burgosej. Kështu që me ni pushkë jonë vra disa shiptarë, e për këtë arsye ka qenë motivi kryesor, ideja kryesore me shkatërru qelulën e kombit që quhet familje, me depërtu në familje me bo vlla-vrasjen, fciu me fqi, ka ndodh edhe vllaznit jon për hir t'pasuris e të tjera jon vra në mes veti, katuni me katun, e të tjera.

Kjo i shkonte ujt në mulli t'Serbisë, okupatorit, për këtë arsye në tubime, nëpër oda, nëpër familje, natën po edhe ditën, a në tubime të mëdha na haptaz e adresonim që gjitha këto gjaqe, këto vrasje, këto vlla-vrasje jon pasoja të okupatorve, të shtetit okupus që ka kriju gjendje t'katandisur t'padurushme kundër shiptarve. Haptaz dhe atë thojshim, në tubim kish, na njëfishin edhe, edhe puntort e sigurimit

shiptart, i shifshim na aty, na përcillshin.

Për shembull, tubimi në katunin afër, Zhegre, tash m'bjën nërmen ai katun, erdhën me 18 pizgavera policija me na ndërpre tubimin e faljeve t'gjaqeve. Tubimi mbahej në një oborr, në një livadh të një familjari aty, dhe në mesin e aty, aty kish profesor nga tana antë e Kosovës gati. Na marrin në pyetje, "Kush je ti? Pse ti?" Atëhere quhej Skenderaji Serbica, "Çka ke lyp ti këtu në këtë katun?" Na marrin në pyetje, na burgosën, na çunë në Gjilan, na marrën në bisedë informative. "Na e dim çka po punoni ju, e kemi dosjen e juj për gjithë këta pajtimtarët. Pse nuk i leni ju gjyqjet, na i kem gjyqjet, i kemi burgjet, le t'mushën burgjet e Serbisë se na kem nevojë për t'burgosun, ata ndërtojnë makina t'lamjes, shporetta, e të tjera, e pasurojnë Serbinë, le t'mushën. Pse po i përzihni ju shtetit, kush jeni ju?"

Për me pajtu ni mijë gjaqe, 1400 dej 1700 gjaqe për ni vjet, ni vjet e gjysë, osht' dashtë ai shtet me pasë me mija prokuror, me mija advokat, me mija gjykatës. Na i bamë këto. U shëndrru intelegjenca e popullit shiptarë, u shëndrru në prokuror, në advokat, në gjykatësa, në profesorë. Kështu që, kjo ishte diçka e jashtëzakonshme, ja lu[jtë]m temelet Serbisë edhe e pa krejt bota se çka po ndodhë. Për shembull, prej ishim në Lumbardh dikun nizat e pesë-gjashtë pajtimtar, erdh në tubimin e Verrave të Llukës gjysëm milioni, po tubimit të Verrave të Llukës i priu tubimi i Bubavecit 300 mijë...Aty erdhën meshtarët, Dom Lush Gjergji, të tjerë që ishin meshtar të kishave katolike shiptare, ku hoxhallartë, islamologët hyjshin në kishë, meshtarët erdhën në xhami edhe u bo uniteti i popullit, bashkimi popullit.

Kjo filloi ni frikë t'madhe, ni panikë t'madhe në Serbi, se dihej se na folshim se do t'fillojmë luftën çlirimtare. Niherë me paqë po, por do ti përdorim edhe armët po që se nuk fitojna me paqë kurgjo. Dhe i nali me ligj, me rregullore, me ligj, i nali tubimet. Po na nuk i përfillshëm, ilegalisht e legalisht i majshëm tubimet nëpër çdo ven. Kështu që, ka me, me... deri në Struzhë, në Kukën e Sharrit kemi shku kemi pajtu atje, e mos t'flasim për Zhur, e për Dukagjin, e për Podujevë e... tubimi në Pallatë, këtu në, afër Dumoshit, te Kuletollt, në fshatin {tund kokën duke kujtuar}, kur Shaban Kuleta falë dy gjaqe, atëhere pjesa dërrmuse e familjeve të Podujevës, të Llapit, ai është ni ven historik, ni ven kombtar Llapi, filloi me i falë të gjitha gjaqet. Ai katun osht' te Batllava, kapun me Batllavë, e kom...

**Aurela Kadriu:** Sveqla, Orllani, Ballabani?

**Behram Hoti:** Ballabani jo. Kul, Kuleta, Kuletoll ka ai katun... tash m'vjen nërmen ma vonë.

**Aurela Kadriu:** A ka pasë zoti Behram gjaqe ndër-fetare, edhe nëse po a mundeni me na i shpjegu pak?

**Behram Hoti:** Gjaqe ndër-fetare në atë kohë? Në atë kohë kanë qenë shumë të rralla, për mos me thonë s'ka pasë fare. Unë kom pasë fatin që meniherë pas lufte, i kom edhe fototgrafitë këtu, menihere pas lufte, gjatë luftës ni familje e besimit muslimon nga katuni Krajkovë e Drenasit, e Drenicës, strehohet në ni familje katolike në katunin Dërsnik të, afër Kline, tre muj ditë. Aty, aty Alberti

bjën në dashuri me ni vajzë, Myrvete. Kjo familje me atë familje që u strehu aty. Fillon ni dashuri e fshehtë edhe kërkush nuk e heton atë dashuri deri sa kryhet lufta.

**Aurela Kadriu:** Domethonë, djali i familjes katolike...

**Behram Hoti:** Djali... me çikën...

**Aurela Kadriu:** Me çikën e familjes muslimane?

**Behram Hoti:** Qashtu, qashtu, qashtu. Edhe kryhet lufta. Ilegalisht, vazhdojnë bisedat ilegale. Dikur vjen koha me shku me çu msitët, të... shkuarsit, po qysh me i çu, kon me çu? Se sipas tradite na e kena majtë familjen këtu, si fmitë tanë, si motrat tona kem kanë, kemi hangër bukë bashkë, e të tjera, e të tjera... dhe ja çonë dajën ajo familje e djaloshit, ja çonë dajën. I kom fotografitë këtu. Ja çonë dajën.

Kur e hetojn ata, se këta të Drenicës, kur e hetojnë se kanë, qenka puna kështu acarohen marrdhanjet, acarohen marrdhanjet për mos me thanë pregaditen, sipas bisedave e raporteve që na erdhën neve, pregaditet ajo familje me bo far hakmarrje, e të tjera, të tjera, të tjera. Por, trokasin fillimisht te Mulla Xhevat Kryeziu, masi që ishte hoxhë. Mulla Xhevati thotë, “Une pasi që jom hoxhë nuk muj me shku me ndërmjetsu, me shiku, me jau mush menën që për m’u bashku këta dy t’ri, jam kundër gjakderdhjes e krejt, po, e kem njeriun, e kem adresën e tij...” N’orën tre t’natës... se u mbyll ajo familje... po, harrova, e lypin kte, kte, kte, ja çojnë, nuk pranojnë. Çika ik edhe shkon në familjen e djalit, e braktis familjen edhe shkon në familjen e djalit, Myrvetja.

Edhe në orën tre t’natës po m’telefonojnë në shpi, mas lufte menihere, dy-tre muj ditë mas lufte. Edhe bashkëshorja tha, “Po ti s’na le rahat para lufte, e në luftë e, e tash mas lufte, po del e po t’vret kush natën”. Thom, “Jo, jo”. “Kon e kërkoni?” Thotë, “Profesorin filan fistekun”. “Po unë jom”. Thotë, “E kemi ni hall t’madh, jemi tre vet te Kroni Bardh në Prishtinë”, quhet ni ven Kroni Bardh në Prishtinë, te xhamija e... te shkolla e Dardanisë. U çova edhe u thashë, “Une e marrë ni gazetë në dorë, natë, që te dini cili jom”. Une paraprakisht e porosita dikon që me nejt ma tutje, thojsha mos o naj kurthë a dishka... shkova, u takova. Plaku, babgjyshi djalit, baba i djalit edhe, edhe kumara i djalit. Kështu, kështu thom, i mora shënimet, “Shkoni në shpi, nesër kah ora dy t’ditës une vi në familjen e juj”. E fillum dhe i pajtum.

**Aurela Kadriu:** Cilat kanë qenë fjalët që i keni përdor ju... ?

**Behram Hoti:** I bindëm se, “Myrvetja osht’ rasisht vajza e juj, motra juj, por ajo osht’ e kombit edhe e popullit. Ka shpreh vullnetin edhe kanë dhanë besën që ata dy t’martohen mes veti. Do t’hetojmë a osht dashuri me dhunë apo dashuri e pastër. Po qëse osht’ me dhunë, do ta sjellëm Myrveten në shpi, po qëse osht’ dashuri e pastër do t’punojmë e nuk do t’lejojmë që kjo dashuri me u shëndrru në tragjedi. Do të mahnitim popullin edhe kombin shiptar, po edhe gjithë kombet tjera t’botës”. Edhe i



pajtum. I pajtum.

Sot, Myrvetja me Albertin jetojnë në Amerikë dhe fjala parë që unë e kom shpreh në familjen e vajzës, të Myrvetes, vllaznit e Myrvetes, krejt ajo familje në luftë, ata m'njifshin mu... edhe tha "O profesor ku t'gjeten ty?" Une në ditën e parë, në momentin e parë ju thashë, "Prej kti veni këtu e deri në Tiranë mik ma t'mirë nuk keni me pasë kurrë". Dhe ajo u dëshmu me ndihmat e tyre njerzore humanitare, miku mikut. Krejt atë shkrum, flejshin në tenda flejshin mas lufte, shkrum ishte bo shtëpija tyre krejt, e fshati tyre. Sot i kanë shtëpijat, kanë rahatën edhe jonë aq t'lumtur me martesën e Myrvetes edhe me martesën e Albertit.

**Aurela Kadriu:** Zoti Behram a keni qenë, po menoja mundeni me na tregu...

**Behram Hoti:** Ajo është familja Gjini, me mbiemër, familja e, jonë, i kom fotografitë e tyre krejt. Edhe për gjitha këto çka kemi, kudo që kemi shku i kemi majtë ditartë. Ditartë. Ja për shembull, këtu e kom ditarin 1997 {prek fletoret që i ka përpara}, 1990, deri pas lufte, ditari 2000, ditari 2000, krejt t'mushne, ja {i shfleton}. Pastaj gjitha këto çka po i flas, ato çka s'muj me i kujtu t'gjitha jonë nëpër librat e botune. Libri parë për pajtimet e gjaqeve botohet 1995 me rastin, përkujtimin, përvjetorin e profesor Anton Çettës, 1995.

Univerziteti, Biblioteka Kombtare ishte okupu prej fashizmit, prej Serbije. Studentët mësonin nëpër, nëpër familje, nëpër shtëpija, shkollat-shtëpija, unverzitetet-shtëpija, shtëpijat-unverzitetet. Ishte Medrezja e Prishtinës që ishte shëndrru në Univerzitet. Dhe kjo libër orakulli, "Anton Çetta, Orakulli i Pajtimet Kombëtar" osht' e shkruar nga populli, nga rinia. Po, emri jem osht' aty po s'osht' vepra ime, ajo osht' vepër e popullit, e rinisë, vepër e atyre njerzve që kanë zgjat dorën e pajtimet, që mos t'ishin ata s'do t'ishin ai. Pastaj vjen libra tjetër menihere "Kuvendi i Bubavecit", e mas këtyre dy veprave vijne edhe veprat e mija, trilogjija, "Fati Madh i Kosovës" 1990, e të tjera, të tjera. Po, i bashkangjitet edhe ni libër shumë e devotshme e Lëvizjes së Pajtimet i Cen Deskut.

Zymer Neziri, Mulla Xhevat Kryeziu, Dom Lushi e shumë meshtarët tjerë, e shumë profesorë tjerë, Mujë Rugova, profesor Bardhyl Çausi të cilin Serbia qato ditët e para t'luftës në Drenicë e kidnapojnë dhe vite me rradhë nuk gjindet kufoma e tij. Ishte kryepajtimtari për regjionin e Gjakovës. Profesor Latif Berisha, kryepajtimtar e profesor i devotshëm i Mitrovicës, ai pushkatohet në prag t'derës t'shpisë. Ndrrojnë jetë shumë, shumë njerz te... kjo....Me këtë epokë Univerziteti duhet t'mirret, duhet t'ketë landë t'posaçme viti '80, '90, '80, '90. '80-tën fillon kryengritja që thashë, demonstratat që rilinden, pajtimi gjaqeve '90, e si pararoje krah i fortë i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, e i Ushtrisë Çlirimtare të Preshevës, e i Ushtrisë Çlirimtare të Tetovës e të Kumanovës osht' pikërisht Lëvizja Pajtimeve të Gjaqeve.

Jeni t'u bisedu me ni njeri i cili edhe në këtë moment, ditët e sotme osht' i shtrim në Shkodër, në gjitha kuvendet e pajtimeve, të gjitha pajtimeve në Tetovë, në Kumanovë, Preshevë. Me qinda pajtimtar, une jom vetëm ni ndër ata pajtimtar, ni ndër ata pajtimtar, po ni ndër ata kordinator sot e kësaj dite. Këtu

duhet përmën profesor Murat Bejtën, profesor Rifat Blakun, profesor të anës të Llapit, Bajram Blakun, hoxhë Bilallin, Idriz Bilalli a si quhet, e të tjerë, e të tjerë...plakun e devotshëm Selim Obranqën, e kom këtu fotografinë me veti gjatë pajtimeve. Selim Obranqa edhe pajtimtarët të cilët ni pjesë e madhe e tyre kanë ndërru jetë, për shembull Haxhi Zekolli i Vushtrisë ni pajtimtar i devotshëm.

Po merita edhe dhurata e Zotit u takon familjeve, nanave. Për shembull, Hyra Gjoshi e fshatit Sankovc të Drenicës, të Glllogovcit, dorasit ja kishin vra babën dhe ishte betu që nuk do t'martohna kurrë, qeizin e kishte ba, kurrë nuk do t'martohna për pa e nxjerrë gjakun. Hyra Gjoshi. Jo, nëpër librat e mija osht' kjo kur t'ju bjen në dorë. Po, kur fillunë në tubime me falë gjakun masovikisht, Hyra Gjoshi e thej betimin, shkoj te varri i ma t'dashunit të saj i tha, "Po e kërkon gjakun Kosova, rinia Kosovës, flamuri kombtar, Univerziteti, po e kërkon lufta, do t'ngritet në luftë Drenica e krejt Kosova". Edhe e fal gjakun.

**Aurela Kadriu:** Cila kishte qenë historia e ktij gjaku?

**Behram Hoti:** Historia e ktij gjaku, njeriu i ka dy sy, po i ka edhe dy sy që nuk shihen, ata janë sytë e mendjes dhe sytë e zemrës. Kur ata trubullohen, nuk vedi... të pavetdijshtëm, atëherë njeriu rrsheet e bjen në prrue. Por, duhet me ja shtri dorën edhe atij me nxjerrë prej prroni e me qit' në rrugë të Zotit e të atdheut edhe me i thanë, "A je pendu zotëri çka ke ba?" Kur osht' fjala te pendesa.... Bisedat që i bonim ne natën, por edhe ligjëratat para tubimeve, 200 mijë, 30 mijë, 25 mijë njerz, ishin aq, të profesorve, aq ligjërata të devotshme kombtare, vizionare, platformë për t'ardhmen se po vjen koha me ba luftë, me marrë pushkën edhe me shliru Kosovën.

Këtu para jush për herë t'parë pej zbuloj pak edhe ni bujashkë t'zembrës time edhe t'përvojës time. Ky njeri ka pajtu edhe nëpër burgje. Për shembull, osht' gjallë edukatori, Demushi i burgut të Lipjanit, që aktualisht po përmënet burgu i Lipjanit. Paraprakisht familja thojke "Profesor, po ai nuk, s'po na merr menja që munet me u pendue. Ata jonë nëpër burgje po nuk jonë pendu, s'kemi ndëgju që jonë pendu". Profesori shkon në burg, une edhe sot e asaj dite jom i licencum nëpër burgje me shku e me i vizitu dorasit. Shkojsha në burg edhe bisedojsha me te, m'ka ra me bisedu edhe me femna edhe ja deklarata, jo që osht' pendu, por forca dhe fuqia e fjalës...

**Aurela Kadriu:** Çka kanë qenë arsyet e ktyne gjaqeve që...?

**Behram Hoti:** Arsyet e ktyne gjaqeve, diçka e padukshme krijohet në shpirtin edhe në mendjen e njeriut. Ajo e padukshme e zbeh durimin, harron njeriu që është njeri, nuk osht' i vetdijshtëm për veprimet e tij, por diçka e padukshme vazhdimisht te dorasit akumulon ni forcë, ni e zezë, që me ja marrë shpirtin njeriu njeriut. Edhe dilli edhe hana nalen, po na nuk kemi sy, e kuvendojnë e lotojnë kur shqiptari e vret shqiptarin, kur burri e furr bashkëshorten e vet, kur burri e vret bashkëshorten e vet...

**Aurela Kadriu:** A ka pasë rast t'tillë?

**Behram Hoti:** Po, shumë, po...

**Aurela Kadriu:** A na tregoni për qato raste?

**Behram Hoti:** Këto raste, prej varfrie, varfria madhe krijon konflikte familjare. Mandej ngritja e ult e arsimimit, shkalla e ult e edukatës, e arsimimit shkakton ata ma t'hidhëru që quhet me ja marrë... me çu dorën burri mbi kokën e grues, e kanihere edhe gruja duhet, u mbrojt edhe i ka metë në dorë burri, e të tjera, e të tjera.

**Donjetë Berisha:** A muni me tregu naj rast specifik, naj ngjarje?

**Behram Hoti:** Jonë kto motive, kto ndodhi, jonë ma t'vjetrome. Në këtë kohë, për shembull, p'i mas lufte e këndej jonë ma t'rralla shumë.

**Aurela Kadriu:** Po qatëhere '90-tat që i keni pajtu, ni rast specifik që ka ndodhë qështu që e ka vra burri grunë ose anasjelltas edhe që ju keni shku me pajtu. Cila osht historia? Qoftë edhe anonim veç ni rast me na tregu.

**Behram Hoti:** Patjetër historia osht varfria...

**Aurela Kadriu:** Po, po...

**Behram Hoti:** Varfria, gjendja sociale e ranë, ni... tash dikush...

**Aurela Kadriu:** Qysh kishin ndodhë këto raste?

**Behram Hoti:** Dikush munet me thonë edhe ka dëshirë vazhdimisht me hetu, une kom thonë që në sekondat e parë do t'flasim për t'vërtetën dhe të drejtën. E, e vërteta, e vërteta osht' shumë kush ka përgoju pastaj, e përgojnë jo për moral e të tjera, tjetra moralisht e ka, e... asniherë ne nuk e kemi fajsu botën femnore. Nëse bota femnore ka gabu ni herë, bota mashkullore që quhet botë shiptare mashkullore ka gabue ni qind herë ma shumë, sepse e shejt osht' nana, ajo osht' e shejt.

Ka, aty kontribojnë e kanë kontribue njerzt që kanë qit' krone t'thata në zjarr, në ven që me shkym, me shkym zjarrin kur ka fillu timi, Na e lujshëm rolin edhe sot e asaj dite e lujm rolin kur t'fillon tymi e me shku me ndal, se kur t'fillon flaka e prushi ajo o kall e shkatrohet. Atëhere në atë kohë nuk ka pasë, ma t'rrallë kanë qenë. Ka pasë edhe pajtimtar të ndryshëm që ni familje, me ni familje i kanë bo katër-pesë gjaqe për ni dardh, e ajo dardh ka qenë...

**Donjetë Berisha:** E a mundeni me na tregu ni rast specifik për shembull cilido qoftë ni pajtim që ka ndodhë, arsyja pse domëthonë ka ndodhë gjaku edhe si ka vazhdu pastaj pajtimi me ndërmjetsimin e

juj?

**Behram Hoti:** Për shembull, osht' fjala e megjave, pasurija e patundshme, jo sipas fjalve t'babës e t'babgjyshit e katragjyshit ktu ka qenë megja, tash ka shku ma poshtë megja e të tjera, të tjera... ose kjo dardh ka qenë në megjë, e imja ka qenë, tash e ke përvetsu ti se ti ma i fortë une ma i lig, ti mashkull, ma shumë e unë ma pak e anej knej. Pajtimtarët e vërtetë si e kanë hetu se dardha osht' fajtoje jonë shku e kanë pre dardhën. Atëherë ata pajtimtar, në thojza, që kanë pasë dëshirë m'u ushqy me atë dardhë, domethonë me keqpërdorë, m'u ushqy me atë dardhë, kanë thonë, "Po, na fikën këta pajtimtarët e ri që erdhën se e pren dardhën, mo nuk kem ku me hongër dardha", e të tjera, të tjera.

Për shembull, osht' ni katun këtu afër, afër Prishtine, na kem pajtu edhe atë, në atë katun, intelektual ka qenë i njoftun, fjalë pas fjale ni djaloshi, e kap sopatën edhe ni djaloshi 13 vjeçar i bjen në ballë këtu {tregon kah koka} edhe e përgjak. Ai ishte me profesion, pasi që osht' gjallë tash e osht' pendue, ishte me profesion jo edukator, por ishte me profesion humanitar. Edhe i pajtum na, i pajtum. Por na kishin dalë policia në rrugë në dy t'natës ka ktheheshin, ka ktheheshim, edhe na nalën. Tha, "Na e dimë kush jeni tek jeni", policija serbe, po kish edhe magjup polic, që i kishin dresu, i kishin trajnue mirë që ata me sjellë maspari, magjupt... dola une prej veture i pari. Ka qenë profesor Kajtaz Rrecaj, ka qenë ky Sa... Prestresha, 25-26 profesor kemi qenë aty.

Dola, se une isha në veturën e parë edhe i grahsha kerrit. I thashë, "Zotni në dy t'natës?" "E dijmë," tha, "kemi dëgju ku ke me shku". "Na shkum me nal gjakderdhjen me bo ni akt humanitar poqëse ti" thashë, "je i Krlevës tregona nëse ki ti naj problem, naj gjakderdhje a dishka me vjehërr," thashë, "se ju mytni për pasuri, me vjehërr, e me motra, e pasuri". Thashë, "Na vimi në Krlevë e t'pajtojmë". "Kemi dëgju," tha, "për ty, osht' vshtir" tha, "me t'mujt ty". Tha "Po, e kom fminë smut dhe ka temperaturë" tha, "nuk po vjen ndihma e shpejtë". "Ku jeton ti?" Tha "në filon ven". Në Graqanicë osht' fjala. Thashë, "Nesër e ki ndihmën e shpejtë në orën kaq kaq aty edhe pediatri, por ki kujdes mos e përdor dorën," thashë, "e stupcin kundër rinisë". Se i plaqkitshin rininë studentore edhe të mesme që vishin nga Gjilani, pikërisht para Graqanice, në punktun e parë aty. E kështu.

Motivet janë, une s'muj me thonë, me fol, me thonë këtë fjalën i ult, se te unë, në fjalorin tim nuk ekziston fjala i lartë, i naltë, njeri i naltë edhe njeri i ult. Ose nuk ekziston fjala zoti filani, zoti filani, veç me emën edhe me mbiemën. Nuk ekziston fjala osht' shkrimtar i madh, osht' pajtimtar i madh, jo mor zotni, i madh o veç Zoti edhe atdheu, Zoti edhe atdheu, dhe mas Zotit dhe atdheut kombi. Këta. E për këtë arsye krejt këto politika, burg, Serbia kishte dëshirë ma shumë shiptar me çu nëpër burgje, me u kriju hasmëri, me u shkatërru familja përmrena. Kur shkatërrohet familja, shkatërrohet kombi. Për këtë arsye na e hetum, e kishëm, e dishëm këte, ja kthym popullit dinjitetin, populli na përkrahu. Kjo është meritë e popullit, po merita i takon rinisë, sidomos rinisë studentore.

## Pjesa e Katërt

**Aurela Kadriu:** Zoti Behram qysh ka vazhdu jeta juj mbas pajtimeve?

**Behram Hoti:** Pajtimet në Shkodër, në Lezhë, Bajram Curr, në Tropojë, në zonën e Kurbinit, kom une fotografi me pajtimtar, atje ka vrasje ma shumë se sa në Kosovë.

**Aurela Kadriu:** Aktualisht?

**Behram Hoti:** Aktualisht. Atje shteti shiptar ka, ka ndërtue ni strehimore për fmi jetima që familjet e tyre janë në bela, se ata kanë ditë m'u marrë edhe fmi, mu hakmarrë me fmi. Për këtë arsye ka [knej] në pjesën jugore ka Skrapari atje, e kanë ndërtu ni strehimore për fmi jetima, që e kanë nanën nëpër burgje, babën nëpër burgje, ose ja kanë vra babën e nanën, për m'i këto...

N'zonën e Kurbinit si kryepajtimtar osht' Gjak Marqi, në Lezhë Nikollë Lleshi, në Zef Sokoli në Shkodër me gjithë pajtimtarët. Ne na thrrasin shpesh edhe pajtimtarët e Kosovës kanë ni autoritet të jashtëzakonshëm në atë anë sepse atje janë vrasjet shumë t'egra në këtë kohë. Sidomos, sidomos mos-durimet familjare, burri me grue, gruja me burrë. Për shembull, ni mosdurim i vllai e privon nga jeta dhonrrin. Motra, tash ai shkon në burg, ose ik në Itali, motra jet vejushkë. Ajo detyrohet m'u martu me kon do qoftë, se t'besimit katolik, ortodoks.

Me qinda vajza shqiptare, po pjesa dërmuse të betimit, te, te, te konfektionit të fesë t'krishtere, krishtere, orthodoxe, zona e Gjako, e Shkodrës, deri në tre qind vajza e ma tepër jonë t'martume në Rashkë të Serbisë, kurse shumë vajza tjera ose gra që kanë metë vejushka jonë t'martume në zonën e Prilepit, në Kumanovë, në Gostivar në atë anë anej, në Manastir në atë anë. Unë kom hyp në tren në ditën e pazarit, kur vjen treni prej Prilepi e nëpër Velesht, e vjen në Shkup dhe jom ulë i padukshëm, i thjeshtë në kupe të trenit. E kom pa femnën me foshnje, çfarë femne, bukuroshe, e shëndetshme, si zanë e malit, fmija si shqiponje sytë, ka i flet shqip, ka i flet shqip fmiut t'vet. Kur erdh ni njeri i çalë, i vjetër, 20 a 30 vjet ma i moshun se ajo femna edhe ja fillunë me fol maqedonisht. Une isha vet i treti.

Pasi që osht' rrugë e gjatë me tren, i thashë këtij kolegut tim, djem t'ri që m'përcjellin mue edhe m'rujn, thashë "Ky masi po del në koridor bashkëshorti i saj, qiky qenka bashkëshorti maqedon, e kjo me fmi po flet". Ajo s'e dinte kush jem na, shka jem... "Masi po flet shqip, kur t'del në koridor, në qofse e pin duhanin në koridor ose shkon ma larg ti me m'sinjalizu kur kthehet me hy në kupe". Dhe e pyta une, thashë, "A bon me t'pyt," shqip, "a bon me t'pyt diçka? Po folni gjuhën shqipe" thashë, "e cilit ven jeni?" Tha, "E Shkodrës, katunit, të Shkodrës". "Po folni shqip, ai zotnia që erdh këtu çka e keni ate?" Tha, "E kom bashkëshort". "Po qysh çka ka ndodhë?" Tha, "Unë jom martu për te". "Po ku o motivi prej Shkodre që ke, në Prilep ke ardhë?" Tha, "Vëllau im e ka vra burrin tim, sepse burri im m'ka keqpërdor, ka pi raki", e të tjera, të tjera, "m'ka lanë pa bukë", e të tjera, të tjera, "m'ka maltretu" e të tjera të tjera.

Tha, "Prej mosdurimit" tha, "unë s'kom gjetë tjetër rrugëdalje, jom ardhë në Maqedoni edhe jom martu". Por, thashë, "Kush ta msoj ty kte kte kte?" "Pikërisht," tha, "jonë ata që na kanë miqasu me këta maqedon" tha, "jonë shiptar, jonë shqip folës". Për përfitime, e mandej tha, "Unë e kom marrë motrën, e motra shoqen" edhe tha, "veç në zonë t'Prilepit" tha, "jemi t'martume dikun ka niqin e

pesdhet femna shqiptare”. Por, maqedoni nuk ka mujt me shku në Shkodër me lyp një vajzë, ose një grue, vejushkë atje m’u martu me te, i ka pri dikush. Ai o shqip folës. Për këtë arsy shteti këtu duhet me qenë shumë i kujdesshëm, i përgjumur jo, me punu. Po lëviz, kjo o lëvizje, vet fjala, lëvizja nuk pushon. Lëvizja është si ajri, nëse kjo natyrë munet me jetu pa ajr, atëhere munet me jetu edhe poplli edhe shteti pa lëvizje.

**Aurela Kadriu:** Zoti Behram, me çka jeni marrë meniherë mbas pajtimeve t’vitet ‘90, ‘91? Qysh ka qenë qajo periudhë për juve?

**Behram Hoti:** Unë jom i largum...

**Aurela Kadriu:** Pra periudha ‘91, ‘90...

**Behram Hoti:** {pohon me kokë} Unë jom i largum prej pune në ‘98-tën, intelektual i parë në Prishtinë i largum prej pune. Jom a... [ndërhyn Aurela]

**Aurela Kadriu:** Ku keni qenë tu punu?

**Behram Hoti:** Në Shtëpi të Shëndetit, referent.

**Aurela Kadriu:** Me çfarë motivi ju largun prej punës?

**Behram Hoti:** Profesor, se s’po flas, une jom edhe magjistër i shkencave albanistike e të tjera, të tjera... Edhe motivi aktet e dhunshme, administrata e dhunshme e Serbisë. Unë nuk e pranova Qeverinë e Serbisë, organet e shtetit t’Serbisë, si prenova edhe ata m’largun prej pune. Lëshun vendimin. Unë nuk e lshova me vullnet vendin e punës. I tha, i thirrën policinë edhe policët m’nxurrën prej vendit t’punës. Prej atij momenti na kemi fillu me punu ilegalisht, qelulat e para të ushtrisë.

Prej dy njerzve, kufiri nuk u thy në vitin 1998, ‘99, kufirin e kanë thy veprimtartë, luftëtartë, dashamirët që nga vitet ‘80-ta, që nga demonstratat e viteve ‘80-ta e në kit anë knej. Vazhdimisht me shtetin amë kem punu në armatimin, në zgjuarsinë, njohuritë e ndihmës t’parë. Sidomos të botës femnore, kem fillu luftën aktive t’armatosur, deri në vitet, deri në qershor t’vitet ‘99 kur kemi hi me brigadë në Prishtinë e në Kosovë.

**Aurela Kadriu:** Zoti Behrami, çka keni vazhdu me bo gjatë luftës?

**Behram Hoti:** Gjatë luftës, kem pajtu në luftë. Ka pasë familje që s’ka, s’kemi mujt me i pajtue gjatë vitit ‘92, ‘90, ‘92, ‘93, ‘94, ‘95... {tregon me dorë} ja këtu ditari osht i ‘97-tës, i kom, i kom intervistat tjera me.... Eh, ka qenë rasti i Paqarizve për shembull të katunit, të katunit Lubizhdë të Malishevës. Kanë qenë t’hasmum mes veti, t’vramë. Pikërisht Paqarizi prej mosdije, prej mosdurimit e privon nga jeta profesorin e nderuer të gjimnazit “Sami Frashër”, midis Malishevës. Na gjatë luftës e përgatitëm pajtimin.

**Aurela Kadriu:** Mhm, qysh e përgatitët pajtimin gjatë luftës?

**Behram Hoti:** Kish autoritet ushtria jonë në luftë, jashtëzakonisht autoritet kish, jashtëzakonisht. Ata që kishin hy në luftë me luftu për atdhe, për komb, për gjeneratat e popullit, për gjeneratat e kombit, për historinë e vërtetë t'kombit, luftë... ato tri shkronja UÇK janë shumë t'shejta. Qysh jonë t'shejtë sytë e njeriut edhe goja e njeriut. Pa sy edhe pa gojë njeriu osht' i verbtë edhe i gjymt. Ky popull pa ushtri, ai osht' i gjymt, osht' i çalë edhe patjetër, patjetër që ushtria edhe policia janë kamtë dhe durtë e trupit tonë edhe trupit tim.

**Aurela Kadriu:** Çka keni vazhdu me bo pas luftës në Kosovë?

**Behram Hoti:** Vazhdimisht pajtime.

**Aurela Kadriu:** Edhe aktualisht vazhdoni...?

**Behram Hoti:** Aktualisht pajtime. Na e kem...

**Aurela Kadriu:** A nuk keni punu mas luftës? A nuk keni punu si profesor?

**Behram Hoti:** A po, jom konë, jom kthy prapë në venin e punës.

**Aurela Kadriu:** Në Shtëpi të Shëndetit?

**Behram Hoti:** Po, po, po se harrova, prapë në ven t'punës {kollitet}

**Aurela Kadriu:** Deri në cilin vit?

**Behram Hoti:** Deri, deri në pension... deri në pension

**Aurela Kadriu:** Që i bjen cili vit?

**Behram Hoti:** Nuk kom kërkue, kom dhonë edhe ligjërata nëpër fakultete ka dy ligjërata në javë, në mujt... nuk kom kërkue.... Jom hy në luftë si professor, kom qëndru në luftë si profesor, jom dal pej lufte si profesor, kom vazhdu jetën si profesor i pajtimeve t'gjaqeve bashkë me Zymer Nerzirin e shumë të tjerë.

**Aurela Kadriu:** N'cilin vit jeni pensionu?

**Behram Hoti:** Paj pasna harru qe besa në cilin vit veç ka, ka nja shtatë vite, qashtu nja shtatë vite jonë...

**Aurela Kadriu:** Edhe vazhdoni t'merreni edhe aktualisht me pajtime?

**Behram Hoti:** Patjetër, vazhdimisht, vazhdimisht bashkë me kolegtë e mi të nderuar të cilët... Eee tash, pajtimet mas lufte...ushtartë e devotshëm, komandantët e devotshëm, kemi bo meniherë mas lufte një pajtim ndërftar, që e përmenët edhe niherë ju, pikërisht në zonën e Malishevës edhe të Prizrenit, në katunin Capar edhe katuni i Shku... i {vë dorën në ballë, kujtohet}, Korishë.

Aty fjalën kryesore e kishte komandanti se vllaznit e vajzës që e kishin marrë, që e kishte, ishte martue me t'besimit katolik. Vllaznit e saj ishin ushtarë t'komandantit edhe ai quhet komandant Gëzim Hazaroli, e shihni tash që në parada ushtarake, edhe na thirrë, na tha, "Profesor, osht' kështu puna. A bo me shku me i pajtue me nalu gjakderdhjen?" Ishin t'pregaditun me bo gjakderdhje, por autoriteti i luftëtarit e boni t'vetën.

Sot e asaj dite jonë kudo... oshtë i Pollatës zavendës, zavendës ministër i Forcave të Armatosura i ushtrisë tonë, Muhamet Latifi i Pollatës. Ai ka qenë gjithmonë i gatshëm me ardhë me, bashkë me profesorin me pajtu hak i kujtdo qoftë, po edhe të tjerë luftetarë të Llapit, edhe Luta, edhe Lata, edhe Remi, edhe të tjerë, të gjithë kanë qenë. Të gjithë unë i njoh për t'mirë, të gjithë kanë qenë kudo që i kom thirrë. Për shembull, mas lufte meniherë e bomë pajtimin e {mendohet} si quhet te Surdullt aty ai fshati, fshati Shajkocv, pajtimin mes familjes Hasan Ramadanit edhe Surdullve. Kishte fillu një vrasje, për shembull, e vrasin dhonrrin edhe ishte në burg ai që kishte...

**Aurela Kadriu:** Vrasësi.

**Behram Hoti:** Edhe ishte meniherë mas lufte, ishte ni ndër komandantët kryesor që ishte ushtar i tij, e unë e njfsha atë familje t'atij, i tubum... Binak Gashi ishte me mu, komandanti oficer i lartë, e të tjerë, e të tjerë edhe me television përpara i pajtum atë familje (i pakupt). Po, para se m'i pajtu, kjo familje e vrau edhe njiherë atë, si e nxurr gjakun e të tjera, të tjera. Na e nalëm gjakderdhjen.

**Aurela Kadriu:** Zotëri Hoti, nëse...

**Behram Hoti:** Edhe sot e asaj dite janë t'gatshëm gjithë oficerët e vullnetit t'mirë bashkë me profesorin që po flet, bashkë me Zymer Nezirin, bashkë me shumë pajtimtar tjerë me pajtu kudo që është nevoja. Tash pajtimet mas lufte kanë qenë t'motivura për pasuri, pasuri për toka e shtëpija të shkive, t'serbve, t'kolonve. Ato nuk jonë shpija, as toka, as të shkive... Ato jonë toka, shpija t'falne prej Serbisë t'vjetër që i ka prue Krali i Serbisë i ka ba koloni. Për shembull, rruga për Podujevë në dy antë ka pasë kolon. Rruga pej Prishtine, pej Devet Jugoviqi atje Bardhoshi tash që thomi, dej në Podujevë ka pasë në te dy antë shtëpija që jau ka maru Krali Nikolla Pashiqi, e të tjera. I ka pru kolonitë t'u e shit pasurinë, ky jo mu m'bjen kjo tokë, jo mu m'bjen kjo arë, anej knej, kanë hi konflikte të ndryshme. I kemi pajtu shumë edhe jemi tuj pajtu shumë. I kemi nalë gjakderdhjen shumë.

**Aurela Kadriu:** Zotëri Behram nëse ju nuk keni diçka me shtu, unë po menoj që mundemi me e përmyll intervistën qitash.

**Behram Hoti:** Unë asgja nuk kom me shtu. Ju dëshiroj fat, maspari televizionit... Eh harrova me thanë rolin kryesor në vitin 1992, '93, '94, rolin kryesor e ka ba televizioni, kombtar shqiptar, RTK Prishtina, masovizimin, ndërkomhtarizimin, dhe "Rilindja". Kur u mbyll televizioni dhe u ndërpre "Rilindja", Kosova ra në terr.

E tash i falenderoj mediat, televizionet ktu edhe shoqatën e juj. Ju dëshiroj gjithë t'mirat ashtu qysh, qysh i dëshiron ky dill edhe kjo hanë ksaj toke edhe qysh i dëshiron ai shi që bjen e e ujitë tokën. Ju



jeni vala. Unë ju dëshiroj fat, shëndet, martesë t'bardhë. Përpara kanë thonë past fat, jo jo, past fat t'bardhë. Prandaj gjithçka duhet elaboru, duhet hetu, duhet hulumtu në këtë jetë vazhdimisht, vazhdimisht.

Ardhmëria është e juja, e brezit t'ri. Fmijët e juj kanë me qenë ma t'lumtur se ju. Fmijët e fmijve t'juj kanë me qenë ma t'lumtur se krejt fmijët e Evropës. Jem gjak i paq. S'i kemi kërkuj borxh prandej ta respektojmë njani tjetrin, ta përkrahmi njani tjetrin, sepse e kemi Zotin e kem atdheun. Bashkimi kombtar ka ndodhë, për çdo ditë është ma afër, e Lëvizja Kombëtare për Pajtimin e Gjaqeve e ka bo bashkimin kombtar, Lëvizja Kombtare... Gjithkombtare për Pajtimin e Gjaqeve e ka kriju UÇK-në, UÇK-ja e krijon tash armatën tonë kombtare shiptare edhe u kry puna.

**Aurela Kadriu:** Faleminderit shumë zoti Behram.

**Behram Hoti:** Ndera dhe lavdia atdheut, e Zotit edhe nanës shiptare.